**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A**

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR**

**PROCEDURËN E KUFIZUAR**

**MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR**

**MALLRA[1][2]**

**OBJEKTI: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA DHE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT, e ndarë në 2 lote:**

**LOTI I: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA, GRADA, STEMA DHE SHENJA PËR POLICINË E SHTETIT**

**LOTI II: BLERJE DHE SHPËRNDARJE KËPUCË PËR POLICINE E SHTETIT**

**MARRËVESHJE KUADËR**

[1] Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, Autoriteti /Enti kontraktor do t'i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

2 Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.

## NJOFTIME

## NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)*

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**;

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

1.2 **Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qendror | Institucioni i pavarur |
| ☐ | ☐ |
| Njësi e autoriteteve vendore | Të tjera |
| ☐ | ☐ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta | Organ Qendror blerës | Ofrues shërbimi | |
| | ☐ | Publik | Privat |
| ☐ | | ☐ | ☐ |
| I deleguar | | Të tjera | |
| ☐ | | ☐ | |

**1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit**:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: ____________________________________________

Tel/faks ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

**1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**

____________________________________________

**1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:** ____________________________

**1.7 Tipi i kontratës**:____________________________________________

**1.8 Fondi limit i përllogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përllogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor**

(*në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjecare*) :
___________________________________________________________________

**1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër :________________________________**

**1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**
_____________________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________________

**1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:**
_____________________________________________________________________

**1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:**
________________________________________________________________

**1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor:**_____________________________________________________________________________
_______________________________________________________________

**<u>Shënim:</u>**

**<u>Nëse ky njoftim paraprak i informacionit përdoret si një ftesë për ofertë, është i nevojshëm informacioni i mëposhtëm:</u>**

**1.12 Përshkrimi specifik i mallrave që do të jenë objekt i kontratës**
__________________________________________________________
_____________________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________________

**1.13 Të përcaktohet nëse kontrata do të jepet përmes procedurës së kufizuar, pa shpallje të mëtejshme të një thirrje për oferta dhe operatorët e interesuar ekonomikë janë të ftuar të shprehin interesin e tyre.**

**_________________________________________________**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor )*

**NJOFTIMI I KONTRATËS**

**Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor**

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri: | **Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a** |
| Adresa: | Rruga "Reshit Çollaku",Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë). |
| Tel/Faks: | 0696092745 |
| E-mail: | sektori_mallrat@obp.al |
| Adresa e ueb-faqes: | www.obp.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | R.N sektori_mallrat@obp.al |

**1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Institucion qendror X

Institucioni i pavarur ☐

Njësi e autoriteteve vendore ☐

Të tjera ☐

**1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐

Organ Qendror blerës X

Ofrues shërbimi Publik ☐ Privat ☐

I deleguar ☐

Të tjera ☐

**1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.6 Kontratë e rezervuar :**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**Seksioni 2: Objekti i Kontratës: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA DHE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT, e ndarë në 2 lote:**

**LOTI I: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA, GRADA, STEMA DHE SHENJA PËR POLICINË E SHTETIT**

**LOTI II: BLERJE DHE SHPËRNDARJE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-44759-04-11-2025**

**LOTI I: REF-44797-04-11-2025**

**LOTI II: REF-44801-04-11-2025**

**2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) 35811200-4 Uniforma Policie**

**2.3 Lloji i "Kontratës Publike për furnizim"**

| Blerje | Marrje me qira | Blerje me këste | Një kombinim i tyre |
|---|---|---|---|
| X | ☐ | ☐ | ☐ |

**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:**

Po **X** Jo ☐

**2. 5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa Operatorë Ekonomikë** **X**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po **X** Jo ☐

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

| |
|---|
| |

**2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:**

**Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: me një operator ekonomik për secilin lot** (*Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)*

Në zbatim të nenit 52 pika 4/a të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar; nenit 64 pika 1/b/i dhe pika 3 përcaktohet se: "Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto

marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të 76 bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Kjo lloj marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues”

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

| | | |
|---|---|---|
| | | Nuk do të ketë rihapje të konkursit.<br><br>Kontrata / kontratat do të lidhen sipas kerkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm për secilin lot.<br><br>Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT.<br><br>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër.<br><br>Ne rast te lindjes se nevojes konkrete per te lidhur nje kontrate për secilin lot brenda marrëveshjes kuader, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasitë përkatëse të artikujve.<br><br>Autoriteti kontraktor i kerkon operatorit ekonomik fitues, te japë oferten e tij.<br><br>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures.<br><br>Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato |

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:** *(këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)*

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**

**2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit total i Marrëveshjes Kuadër: **Blerje dhe shpërndarje uniforma dhe këpucë për Policinë e Shtetit,** është 2,724,218,857.45 (dy miliard e shtatëqind e njëzetë e katër milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 27,539,616.43 (njëzet e shtatë milion e peseqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë dyzet e tre) Euro pa TVSH.

**Vlera e fondit limit total për Lotin I: Blerje dhe shpërndarje uniforma, grada, stema dhe shenja për Policinë e Shtetit** është 1,962,264,441.82(një miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzet e një pikë tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 19,836,882.75 (nëntëmbëdhjetë millîon e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

**Vlera e fondit limit total për Lotin II: Blerje dhe shpërndarje këpucë për Policinë e Shtetit** është 761,954,415.63 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e një million e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe 7,702,733.68 (shtatë million e shtatëqind e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 10.04.2025, me kurs këmbimi 98.92 (nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e dy)lekë.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është: nuk është e aplikueshme** (**Monedha), pa TVSH.**

3. Burimi i financimit: **Buxheti i shtetit për vitet 2025, 2026,2027 dhe 2028**

4. Kodi Output: **1234567**

5. Tipi:

Investime □ Kodi: ______ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 602 Vlera: 2,724,218,857.45 (dy miliard e shtatëqind e njëzetë e katër milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 27,539,616.43 (njëzet e shtatë milion e peseqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë dyzet e tre) Euro pa TVSH

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**

**ose ditë** □□□

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj: 48 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër** |
| *Ose* **fillon më ____/____/________ (d/m/v)** |
| **mbaron më ____/____/________ (d/m/v)** |

**2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:**

**2.13 Ndarja në Lote:**

**Po** X **Jo** □

*Nëse po,*

**2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:**

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

**Objekti: LOTI I: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA, GRADA, STEMA DHE SHENJA PËR POLICINË E SHTETIT**

Vlera e fondit limit total për Lotin I: "Blerje dhe shpërndarje uniforma, grada, stema dhe shenja për Policinë e Shtetit" është 1,962,264,441.82 (një miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzet e një pikë tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 19,836,882.75 (nëntëmbëdhjetë million e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

**Objekti: LOTI: II BLERJE DHE SHPËRNDARJE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT**

**Vlera e fondit limit total për Lotin II: "Blerje dhe shpërndarje këpucë për Policinë e Shtetit"** është 761,954,415.63 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e një million e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe 7,702,733.68 (shtatë million e shtatëqind e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 10.04.2025, me kurs këmbimi 98.92 (nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e dy)lekë.

**2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:**

□ një Lot,

□ disa Lote,

X të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:**

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi: Të gjitha lotet

**2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

*Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetem ne lotin/et ne te cilin/et oferta e tij eshte ekonomikisht me e favorshme.*

**2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**

**Po** ☐ **Jo** X

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

**2.15 Pranohen variantet:**

**Po** ☐ **Jo** X

**2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**

**Po** ☐ **Jo** X

**Shënime të tjera** *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

_____________________________________________________________

______________________________________________________________________

________________________________________________________________

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

| **Po** | X | **Jo** | ☐ |
|---|---|---|---|

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:**

Bazuar në nenin 90 *të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar,* ndalohet mbeshtetja per:

1**. Kapaciteti ekonomik dhe financiar për sa i përket** vërtetim për xhiron vjetore;

**2. Kapaciteti teknik** për sa i përket dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme.

Njësia e Prokurimit gjykon se ndalimi i mbështetjes në pikat e sipërcituar është i nevojshëm për arsyet si më poshtë:

1. **Ndalimi i mbështetjes në subjektet e tjera** për Kapaciteti ekonomik dhe financiar për sa i përket **vërtetimit për xhiron vjetore**, është gjykuar i nevojshëm për të garantuar siguri dhe stabilitet financiar të për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Një operator ekonomik duhet të demostrojë që ka burimet e veta financiare për të përmbushur detyrimet e veta kontraktuale. Nëse operatori ekonomik mbështetet në subjektet e tjera për kapacitetin financiar ekziston rreziku që këto subjekte të mos i përmbushin premtimet ose detyrimet ndaj operatorit që ka kërkuar mbështetje, duke vënë në rrezik realizimin me sukses kontratës objekt prokurimi.

Pavarsia dhe përgjegjësia e operatorit ekonomik.

Mbështetja në kapacitetet financiare të subjekteve të tjera mund të dobësojë pavarsinë e operatorit ekonomik pasi mund të behet i varur nga palët e treta. Për të siguruar që operatori është plotësisht përgjegjës dhe i aftë për të zbatuar kontratën, kërkohet që ai të ketë kapacitet financiar të pavarur.

Vështirësitë në garantimin e përmbushjes së detyrimeve.

Edhe pse një subjekt tjetër mund të deklarojë mbështetje financiare, nuk ka asnjë garanci absolute qe kjo mbështetje do të ofrohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të kontratës. Në raste të tilla, autoriteti kontraktues mund të hasë probleme për të zbatuar penalitetet ose për të siguruar ekzekutimin e kontratës.

Duke mos lejuar mbështetjen në kapacitetet financiare të subjekteve të tjera, autoriteti kontraktues synon të sigurojë që vetëm operatorët ekonomikë që janë realisht të aftë dhe të qëndrueshëm financiarisht të marrin pjesë dhe te realizojnë kontratën.

Ky kriter siguron stabilitet në zbatimin e kontratës dhe parandalon rreziqet e mundshme që mund te dalin nga varësia financiare ndaj palëve të treta.

**2. Ndalimi i mbështetjes në subjektet e tjera për** Kapacitetin teknik për sa i përket **furnizimeve të mëparshme të ngjashme**, është gjykuar i nevojshëm, për të garantuar se operatori ekonomik ka ekspertizën/përvojën e nevojshme për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë efikase dhe cilësore.

Një operator ekonomik që nuk ka kryer furnizime të ngjashme vetë, nuk mund të demostrojë aftësi praktike dhe përvojë të mjaftueshme në realizimin e kontratës. Mbështetja në subjektet e tjera mund të krijojë një situatë ku operatori ekonomik fitues nuk ka ekspertizën e nevojshme për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë efikase dhe cilësore.

Moslejimi i mbështetjes garanton që operatori ekonomik i vetëm është përgjegjës për performacën e kontratës. Nëse lejohet mbështetja te subjektet e tjera për furnizimet e ngjashme, mund të krijohen

probleme në monitorimin e cilësise dhe përgjegjësisë në rast dështimi, duke pasur parasysh natyrën dhe objektin e kontratës.

Autoriteti kontraktues synon të minimizojë rreziqet e mundshme në zbatimin e kontratës .

Furnizimet e ngjashme janë një tregues i aftësisë së operatorit për të kryer furnizime të cilësisë dhe të standarteve të kërkuara për këtë objekt prokurimi.

Furnizimet e ngjashme të realizuara drejtpërdrejt nga operatori ekonomik janë dëshmi e aftësisë për të kuptuar kërkesat e tregut, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe përmbushjen e afateve. Ky kriter synon të rrisë përgjegjshmërinë, të mbrojë konkurrencën e ndershme dhe të minimizojë rreziqet në furnizime duke siguruar që kontrata t'i besohet një operatori të aftë dhe të provuar.

**2.17 <u>Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:</u>**

**Po** □ **Jo** X

**<u>2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:</u>**

**Po** □ **Jo** X

**<u>Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike</u>**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (*e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, **sipas Shtojcës 5.**

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës totale për objektin "**Blerje dhe shpërndarje uniforma dhe këpucë për Policinë e Shtetit",** është 54,484,377.15 (pesëdhjetë e katër milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesëmbëdhjetë) lekë dhe 550,792.33 (pesëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy pikë tridhjetë e tre) Euro.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 10.04.2025, me kurs këmbimi 98.92 (nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e dy)lekë.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës për **Lotin I: "Blerje dhe shpërndarje uniforma, grada, stema dhe shenja për Policinë e Shtetit"** është është 39,245,288.84 (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e katër) lekë 396,737.66

(treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro.
Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës për **Lotin II: "Blerje dhe shpërndarje këpucë për Policinë e Shtetit"** është 15,239,088.31 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e një) lekë pa TVSH dhe 154,054.67 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Euro.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 10.04.2025, me kurs këmbimi 98.92 (nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e dy)lekë.

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a (*të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor*)

| **Nr.** | **Banka** | **Nr. llogarise** |
|---|---|---|
| **1** | **Credins** | **AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030** |

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare X
ose
ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150** *(njëqind e pesëdhjetë) ditë*

**<u>Seksioni 4: Procedura</u>**

**4.1 Lloji i procedurës: E Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, mallra, kontratë**

"Procedurë e kufizuar", mbi kufirin e lartë monetar, e parashikuar në nenin 43 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenin 48 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

*Procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.*

*Në përzgjedhjen e kësaj procedure prokurimi është mbajtur në konsideratë fakti* se, *në të mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, pasi nuk do të aplikohet kufizimi i numrit te operatorëve ekonomikë ofertues. Nuk do të aplikohet ulja e numrit të kandidatëve që do të ftohen me qëllimin e vetëm se, moskufizimi i numrit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar siguron një proces më të hapur dhe transparent, duke rritur besimin e palëve të interesuara në integritetin e procesit të prokurimit. Të gjithë operatorët e kualifikuar kanë mundësinë të konkurrojnë duke promovuar parimin e mundësive të barabarta. Moskufizimi i numrit të operatorëve të kualifikuar lejon një fleksibilitet më të madh në përzgjedhjen e ofertave që janë më të përshtatshme për kërkesat specifike të këtij procesi. Përzgjedhja e kësaj procedure prokurimi është bërë duke mbajtur gjithashtu në konsideratë vlerën e lartë të fondit limit për lidhjen e marrëveshjes kuadër,*

*kompleksitetin dhe rëndësinë e artikujve që prokurohen, të cilët janë artikuj që lidhen ngushtësisht me përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit.*

*Meqënëse kemi të bëjmë me artikuj për uniforma dhe këpucë për punonjësit e Policisë e Shtetit, cilësia e zgjedhjes së operatorëve ekonomik fitues duhet të jetë maksimale, bazuar në kapacitet ligjore, teknike, profesionale dhe financiare të tyre,* pasi *vetëm operatorët ekonomikë që plotësojnë kriteret e kualifikimit si më sipër, mund të marrin pjesë, duke siguruar që ofertat të jenë nga kompani të kualifikuara, serioze, të besueshme dhe me përvojën e duhur me qëllim realizimin me sukses të marrëveshjes kuadër që do të lidhet. Blerje dhe shpërndarja e uniforma dhe këpucë për punonjësit në Policinë e Shtetit, kërkon një nivel të lartë ekspertize dhe përvoje për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e artikujve objekt prokurimi.*

*Proçedura e kufizuar lejon përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që kanë dëshmuar aftësitë dhe përvojën e nevojshme në këtë fushë. Procedura e kufizuar siguron që konkurrenca të fokusohet tek cilësia dhe cmimi i ofertës duke eleminuar ata ofertues që nuk plotësojnë as kriteret minimale të kualifikimit.*

*Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 55, datë 27.1.2016 "Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit", të ndryshuar është miratuar paraqitja, forma dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit, sipas albumit me 54 faqe, që i bashkëlidhet këtij vendimi, tregon për rëndësin që ka uniforma e Policisë së Shtetit, e cila përbën jo vetëm prezantimin publik të Policisë së Shtetit, por është dhe si një vlerë shpirtërore e një kombi, si vlera më e rëndësishme e Policisë së Shtetit.*

*Procedura e kufizuar siguron që artikujt objekt prokurimi të jenë të sigurta dhe në përputhje me standartet e kërkuara, duke mbrojtur përdoruesit e tyre dhe reputacionin e autoritetit prokurues dhe përfitues të kësaj marreveshje kuadër. Faza e dytë e këtij proçesi do të përcaktojë dhe fituesin sipas çmimit më të ulët të ofruar.*

**4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:**

**Po** ☐ **Jo** X

Nëse Po, numri i referencës është _____________________

**4.2.1.Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

**Po** ☐ **Jo** **X**

**4.3 Procedurë e rishpallur:**

**Po** ☐ **Jo** X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit_____________________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit ___________________________

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____________________________(*shuma* , *monedha*)

**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) [3] **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

çmimi □ pikët□□

_______□□ pikët □□

_______ □ □ pikët □□

_______ □□ pikët □□

<u>Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.</u>

**<u>OSE</u>**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

**<u>Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi</u>** (*Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).*

**4.5 Ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen:**

**4.5.1 Do të aplikohet ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen:**

**Po** □ **Jo** X

***Nuk do të aplikohet ulja e numrit të kandidatëve që do të ftohen me qëllimin e vetëm se moskufizimi i numrit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar siguron një proces më të hapur dhe transparent, duke rritur besimin e palëve të interesuara në integritetin e procesit të prokurimit. Të gjithë operatorët e kualifikuar kanë mundësinë të konkurrojnë duke promovuar parimin e mundësive të barabarta. Moskufizimi i numrit të operatorëve të kualifikuar lejon një fleksibilitet më të madh në përzgjedhjen e ofertave, që janë më të përshtatshme për kërkesat specifike të këtij proçesi.***

Nëse Po:

Numri minimal i kandidatëve që do të ftohen është: __________________

Numri maksimal i kandidatëve që do të ftohen është (sipas rastit): __________________

---

[3] Shënim. *Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

**4.5.2 Kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për uljen e numrit të kandidatëve:**

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

**4.6 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:**

Data: **19/05/2025***(d/m/v)* **ora 11:00**

Vendi: ________________________________________

**Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.**

**4.7 . Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 43 pika 7 të LPP** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

**Po** ☐ **Jo** X

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

| |
|---|
| |

**4.8 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip** X **Anglisht** X

________________

**Seksioni 5: Informacione shtesë:**

**5.1 Dokumente me pagesë** *(zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

**Po** ☐ **Jo** X

*Nëse po*

**Monedha** _________ **Çmimi** _______

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (**kur është e aplikueshme)

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softëerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 14/04/2025

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FTESË PËR SHPREHJE INTERESI**

**Procedura e Prokurimit**: ______________________________

(*shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje në procedurën për furnizimin e mallrave në vijim:

…………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të mallrave dhe sasisë së kërkuar)

**Kërkesat për pjesëmarrje duhet të paraqiten në:**
*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje:**

[Përcaktoni datën dhe orën]

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit*]

**FTESË PËR OFERTË**

(*Shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për furnizimin e mallrave në vijim:

……………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të mallrave dhe sasisë konkrete të kërkuar:

**<u>Vendi i dorëzimit të mallrave</u>**<u>: </u>(jepni një përshkrim të shkurtër*)*___________________

**<u>Koha e dorëzimit/lëvrimit</u>**: Mallrat duhet të dorëzohen brenda datës ____________

**<u>Ofertat duhet të paraqiten në:</u>**
…………………………………………………………………………………… *[jepni adresën e saktë*]

**<u>Afati i fundit për pranimin e ofertave:</u>**

…………………………………………………………………………………………………

[Përcaktoni datën dhe orën]

**Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese _______________________________________**

**Forma e komunikimit:**

Forma shkresore□ Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) □

## NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku",Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
Tel/Faks: 0696092745
E-mail: sektori_mallrat@obp.al
Ueb-faqe: www.obp.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** "Proçedurë e Kufizuar"**,** mbi kufirin e lartë monetar, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtët janë të përcaktuar, me një operator për secilin lot.

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-44759-04-11-2025**

**LOTI I: REF-44797-04-11-2025**

**LOTI II: REF-44801-04-11-2025**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "**Blerje dhe shpërndarje uniforma dhe këpucë për Policinë e Shtetit"

Loti I: "Blerje dhe shpërndarje uniforma, grada, stema dhe shenja për Policinë e Shtetit"
Loti II: "Blerje dhe shpërndarje këpucë për Policinë e Shtetit"

**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** 35811200-4 Uniforma Policie

**6. Fondi limit total i marrëveshjes kuadër**: "**Blerje dhe shpërndarje uniforma dhe këpucë për Policinë e Shtetit",** është 2,724,218,857.45 (dy miliard e shtatëqind e njëzetë e katër milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 27,539,616.43 (njëzet e shtatë milion e peseqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë dyzet e tre) Euro pa TVSH.

**Vlera e fondit limit total për Lotin I: "Blerje dhe shpërndarje uniforma, grada, stema dhe shenja për Policinë e Shtetit"** është 1,962,264,441.82(një miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzet e një pikë tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 19,836,882.75 (nëntëmbëdhjetë million e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

**Vlera e fondit limit total për Lotin II: "Blerje dhe shpërndarje këpucë për Policinë e Shtetit"** është 761,954,415.63 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e një million e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe 7,702,733.68 (shtatë million e shtatëqind e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 10.04.2025, me kurs këmbimi 98.92 (nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e dy)lekë.

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 48 (dyzetë e tetë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 19/05/2025; ora 11:00**

**9. Procedurë e Rishpallur:**

| **Po** | ☐ | **Jo** | **X** |
|---|---|---|---|

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit________________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _________________________

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit ___________________________(*shuma* , *monedha*)

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**

**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Mallra:

Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër ____

| Numri i kontratës | Titulli i kontratës | Përshkrimi i shkurtër i kontratës |
|---|---|---|
| 01 | __________ | _______________ |
| 02 | __________ | _______________ |
| 03 | __________ | _______________ |
| … | __________ | _______________ |

Shënim: *Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.*

(*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* )

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

1. **Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

2. **Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ______________________________________________

E-mail______________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: ______________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: _____________________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:_________________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _______________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_______________**

**8. Fondi limit :____________________________________________**

**9. Justifikimi, argumentet përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumenteve të tenderit:**

________________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________________

______________________________________

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:___________**

**<u>Shënim:</u>**

**Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentet e tenderit.**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe____________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ______________________________________________

E-mail ____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: ______________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër:_____________________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:_________________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :_______________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_______________**

**8. Fondi limit: ____________________________________________**

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

______________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________________

_______________________________________

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:**

______________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________________

**11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: _______________________________**

**12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):______________________________________**

**13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: ________________________**

**Dhe afati i ri (nëse është rasti): ____________________________**

**14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:**

Emri____________________________

NIPT: _______________________

Adresa ___________________________

Kontaktet __________________________

**15. Data e nënshkrimit të modifikimit :**______________________

**16. Burimi i financimit:** ________________________________

**17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor**______________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

# DOKUMENTET E TENDERIT

**Përmbajtja:**

**Seksioni I:** **Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit te Kontratës.

**Seksioni II:** **Shtojcat**

**Seksioni II** përfshin Shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e Kerkeses per Pjesemarrje dhe /ose ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, sasia dhe grafiku i lëvrimit.

**Seksioni III.** **Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

**Seksioni III** përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

**Seksioni IV:** **Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

**Seksioni IV** përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

# Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

## A. TË PËRGJITHSHME

**1. Objekti i prokurimit**

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.

2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

Kjo procedurë përbëhet nga dy faza kryesore:

**Faza 1- Parakualifikimi:** Kandidatët do të paraqesin dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti / Enti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentet e paraqitura nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Faza 2 - Ftesa për oferta**: Autoriteti / Enti Kontraktor i dërgon ftesë për ofertë Kandidatëve të cilët kanë përmbushur kërkesat e parakualifikimit, me anë të së cilës i fton këta Kandidatë të paraqesin një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të rishikohen dhe vlerësohen nga Autoriteti / Enti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

**2 Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm**

a) Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

-Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1. Të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare.

1.2. BOE i bashkëlidh kerkesës për pjesëmarrje dhe Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Kerkesës për Pjesëmarrje dhe /ose Ofertës.

**3. Sqarimi i Njoftimit të Kontratës dhe Dokumenteve të Tenderit**

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje dhe/ose ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit**

4.1 Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje/ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.

4.2 Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i Dokumenteve tëTenderit.

4.3 Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e tyre. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e tyre me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

## B. PËRGATITJA E KËRKESËS PËR PJESËMARRJE DHE OFERTAVE

**5. Shpenzimet e ofertimit**

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e Kërkesës për Pjesëmarrje/Ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

**6. Gjuha e Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

**7. Dokumentet përbërëse të Kerkese per Pjesemarrje/ Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

| | | |
|---|---|---|
| **8.** | **Formularët e tenderit** | 1 Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.<br><br>2 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës për pjesëmarrje/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës për pjesëmarrje /ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesën për pjesëmarrje /ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personi (at) e Autorizuar. |
| **9.** | **Ofertat Alternative** | Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh. |
| **10.** | **Përllogaritja e Ofertës Ekonomike** | 1 Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.<br><br>2 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasitë dhe çmimin e tyre.<br><br>3 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.<br><br>4 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.<br><br>5 Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër. |
| **11.** | **Monedhat** | Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës. |
| **12.** | **Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik** | Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat. |

| | |
|---|---|
| **13. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës** | 1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.<br>2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:<br>a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor<br>b) Garanci bankare<br>c) Garanci sigurimi<br>Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.<br>3 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.<br>4 Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë Operatori Ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet. |
| **14. Formati dhe Nënshkrimi i kerkeses per pjesemarrje dhe Ofertave** | Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet Kërkesën për Pjesëmarrje sipas formularëve standard në këtë DT e cila do të nënshkruhet nga personi/at i autorizuar për këtë qëllim. Kur të ftohet nga autoriteti/ enti kontraktor për të paraqitur një ofertë sipas formularëve standard në këtë DT, Oferta do të nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim. |
| **15. Konfidencialiteti** | Autoriteti /enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së |

## C. PARAQITJA, HAPJA DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE /OFERTAVE

| | |
|---|---|
| **15. Kërkesa për** | Operatori ekonomik paraqet Kërkesë për Pjesëmarrje/Ofertën duke përdorur formularet e paraqitur në Seksionin II dhe III. Formularër duhet të plotësohet pa asnjë ndryshim të formatit të tij, dhe nuk do të pranohen |

**Pjesemarrje /Oferta**

zëvendësime. Të gjitha hapësirat boshe do të plotësohen me informacionin e kërkuar.

**16. Dokumente që provojnë kualifikimet e operatorit ekonomik**

1 Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat .

2 Mosparaqitja e informacionit, i cili është thelbësor për të vlerësuar kualifikimet e operatorit ekonomik, do të rezultojë në skualifikimin e operatorit ekonomik.

**17. Paraqitja, e kërkesës për pjesëmarrje/Ofertës**

1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatori ekonomik ngarkon kërkesën për pjesëmarrje/ofertën në Sistemin e Prokurimit Elektronik sipas përcaktimeve në manualet përkatëse.

2 Sa i takon procedurave të prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, operatori ekonomik paraqet vetëm kërkesën origjinale për pjesëmarrje/Ofertës të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e operatorit ekonomik dhe të shënuar: "**Kërkesë për pjesëmarrje/Ofertë; Njoftimi Nr. __.” MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA -------------- d/m/v, në orën------------”**

**18. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje /Ofertës**

Kërkesa për pjesëmarrje/Oferta duhet të merret dhe hapet nga autoriteti/ enti kontraktor jo më vonë se data dhe ora e përcaktuar në njoftimin e kontratës/Ftesë për Ofertë.

**19. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë kërkesën për pjesëmarrje/Ofertën, në çdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të saj.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin kërkesëspër pjesemarrje/Ofertënme kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit /entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e tyre. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM Kërkesë për pjesëmarrje/Oferte” ose "TËRHEQJE Kërkesë për pjesërmarrje/Oferte

**20. Kualifikimi i operatorëve ekonomikë**

1. Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet

se Kërkesa e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Kërkesës për Pjesëmarrje/Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP) .

## D. NJOFTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

**21. Njoftimi i kualifikimit apo përzgjedhjes**

1 Autoriteti/enti kontraktor njofton operatorët ekonomikë për rezultatet e fazës së parë të procedurës. Ky njoftim përfshin, minimalisht: emrat e operatorëve ekonomikë të kualifikuar apo operatorëve ekonomikë të përzgjedhur për tu ftuar për të paraqitur oferta.

2.Njoftimi që duhet t'i dërgohet operatorëve ekonomikë do të deklarojë arsyet specifike për refuzimin e kërkesës së tyre për pjesëmarrje..

**22. Ftesa për ofertë**

Autoriteti/ enti kontraktor do të ftojë të paraqesin ofertë për kontratën vetëm ata operatorë ekonomikë që janë kualifikuar në fazën e parë.

## DH. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

**23. Paraqitja e Ofertave**

Ofertat do të paraqiten vetëm nga operatorët ekonomikë që kanë marrë një ftesë për ofertë nga autoriteti/ enti kontraktor.

**24. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

**Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formularin e Ofertës Ekonomike.
b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (specifikimet teknike, broshura etj)
___________ ,
___________ ,
c) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

**E. SHQYRTIMI I OFERTAVE**

**25. Përgjegjshmëria e ofertave**

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

(a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
(b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
(c) "**Mospranim"** është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

**F. VLERËSIMI I OFERTAVE**

**26 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kritereve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**<u>Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:</u>**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

**a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 ____Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Ok1 x Pmaxk1 /Vmax k1

Vmaxk1_____Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 ______ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës së kualifikuar.

**SHËNIM: 1.** Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin eKontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

**27. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

**(a)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

**2**. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

3 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + … On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ......... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

## G. DHËNIA E KONTRATËS

**28. Njoftimi i Fituesit**

Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

| | |
|---|---|
| **29 Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës** | 1 Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën. |

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

b) garanci bankare

c) garanci nga shoqëri sigurimi.

## I. ANKESAT

**30. Procedura e ankesës**

1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t´u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2.Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

**31 Anulimi i procedurës**

1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatëshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021 të ndryshuar.

3.Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4.Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njejtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në sistemin e prokurimit elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

**SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për Pjesëmarrje Faza I

Shtojca 2. Formulari i Ftesës për Ofertë për kandidatët e përzgjedhur Faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4 Lista e Çmimeve të Artikujve

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 7. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 8. Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit

Shtojca 9. Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes/Kualifikimit

Shtojca 10. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimim.

Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtoja 14. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15 .Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

**Shtojca 1**

*(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)*

**FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE**

Emri i Operatorit Ekonomik____________________

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i procedurës / referenca e Lotit __________

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/ përzgjedhur bazuar në kerkesen për pjesëmarrje)*

**FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË PËR KANDIDATËT E PËRZGJDHUR FAZA II.**

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

_____________________________________________

Procedura e prokurimit__________________________________

Numri i procedurës / referenca e Loti: ________________________________

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/ enti kontraktor]

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:**

Data //(d/m/v) Ora: _____________________________

Adresa_____________________________________________________________________________

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, **www.app.gov.al.**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:**

Shqip ☐ Anglisht ☐

Tjetër _________________________

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) [4]**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

Çmimi □ pikët□□

_______□□ pikët □□

_______□ □ pikët □□

______ □□ pikët □□

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

**OSE**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim** □

**Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (***Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasitë janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).*

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

**[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]**

[4] *Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

**Shtojca 3 .**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**[5]

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*]**), nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**c)** Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e kontratës;
3. Kriteret e përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

**e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: **------------ [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |

[5] *Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.*

| | |
|---|---|
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë ________________** | |

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data**: ____________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: ___________________________________**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| ***1*** | ***2*** | ***3*** | ***4*** | ***5*** | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Përshkrimi i mallit** | **Sasia** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total për artikull (*3* x *4X*)** | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | **Çmimi total (Mallrat)** | | | | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 6**

*(Shtojce për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 7.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

*b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit*

c*) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkelidhur DST

Specifikimi i Materialeve:

**Specifikimet teknike për artikujt objekt prokurimi, për të dy lotet, janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Bashkëlidhur dokumentave të tenderit do të jenë anekset nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, nr.7 dhe nr.8.**

Lidhur me standardet e vendosura në specifikimet të uniformave Autoriteti Kontraktor hartues i specifikimeve teknike sqaron se: këto standarde janë kërkesat baze dhe shtese për kushtet teknike të domosdoshme qe duhet të plotësojnë artikujt e uniformës, për standardët me datë do të pranohen të përditësuar, dhe për standardët pa datë do të zbatohet botimi i fundit duke përfshirë çdo përmirësim apo ndryshim.

Në anekset e specifikimeve teknike të uniformave, bashkëlidhur dokumenteve standarte të tenderit, ka specifikime teknike per disa artikuj që nuk janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ne kete procedure, por jane perfshire për arsye se ato janë bllok i anekseve të specifikimeve të miratuara dhe nuk mund të ndahen për këtë procedurë prokurimi.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Termat e referencës si më poshtë vijon janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.**

## TERMAT E REFERENCËS

"BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA DHE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT"

Autoriteti Kontraktor (AK) - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit paraqet termat e referencës për tu patur parasysh nga operatorët ekonomikë në momentin e hartimit të ofertave të tyre teknike dhe ekonomike.

### 1. Miratimi i modelit për prodhim.

Operatori ekonomik fitues, para fillimit të prodhimit, të paraqesë nga dy modele fizike të çdo artikulli të cilët duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e AK. Ky model që do të shoqërohet me fletë analizë, do të kalojë në një fazë vlerësimi dhe do të miratohet si prototipi zyrtar me të cilin do të krahasohet produkti përfundimtar. Pa miratimin e modelit nga AK nuk duhet të fillojë prodhimi i kontraktuar.

### 2. Evidentimi i masave trupore të punonjësve të policisë.

Operatori ekonomik i zgjedhur fitues ka përgjegjësi për krijimin e bazës së të dhënave të masave trupore të punonjësve të policisë, për çdo kontratë duhet të bëjë evidentimin e masave të veshjeve të çdo punonjësi të policisë në të gjitha njësitë shpenzuese (strukturat policore përfshirë kursantët dhe studentët në Akademinë e Sigurisë).

Për këtë operatori ekonomik fitues përpara fillimit të prodhimit duhet të marrë masa për:

- Krijimin e bazës së të dhënave të përmasave trupore të gjithë punonjësve të policisë;
- Evidentimin e përmasave trupore të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit;
- Konvertimin e përmasave trupore në masa të veshjeve;
- Dorëzimin e përmasave të detajuar të veshjeve sipas masave dhe prerjeve për secilin artikull.

Për këtë Operatori Ekonomik mund të angazhohet vetë ose të kontraktojë një studio për llogari të tij. Pas evidentimit të masave trupore të bëhet konvertimi i përmasave trupore në përmasa të veshjeve për çdo artikull. Mbi këto masa të evidentuara do të ngrihet baza e të dhënave e masave të veshjeve dhe do të dorëzohet në formatin elektronik pranë AK sipas strukturave policore dhe sipas llojit të uniformave. AK do të monitorojë procesin e përditësimit të bazës së të dhënave me ndryshimet.

### 3. Plani i prodhimit.

Në momentin e evidentimit të masave që do të prodhojë operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë AK planin e prodhimit të artikujve të uniformës, me afatet e përcaktuara. Plani i prodhimit duhet të jetë i ndarë sipas llojit të uniformave që do të prodhohen.

### 4. Kontrolli i lëndëve të para në fazën e prodhimit.

Me qëllim garantimin e cilësisë së produktit të pritshëm, AK mund të ushtrojë kontrollojë dhe verifikojë lëndët e para dhe ndihmëse që në fazën e prodhimit të tyre, si dhe gjatë kohës së prodhimit të uniformës

– produkt i gatshëm duke bërë inspektime pranë fabrikave që janë kontraktuar. Për këtë operatori fitues do të deklarojë të gjithë furnitorët e lëndëve të para, dhe ato të prodhimit të uniformave.

5. **Kolaudimi.**

Pas kontrollit në prodhim, kolaudimi ose kontrolli cilësor i artikujve do të kryhet në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar.

6. **Afatet e lëvrimit.**

Prodhimi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që furnizimi me uniforma i punonjësve të policisë të bëhet sipas sezoneve të verës apo dimrit, në mënyrë që të mbulohen nevojat në kohë. Lëvrimi i artikujve të uniformave verore duhet të kryhet jo më vonë se data **1 Maj** të çdo viti dhe lëvrimi i uniformave dimërore duhet të kryhet jo më vonë se data **1 Tetor** të çdo viti.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruahet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë dhe jo me shume së 150 ditë nga lidhja e kontratës. Për çdo rast sasitë e kërkuara në kontatën e parë nuk do të jenë më tepër se 50 % e sasive të pritshme të vitit të parë.

7. **Procesi i Shpërndarjes**

Artikujt e uniformës pas kolaudimit do të magazinohen në ambjetnet e AK (Qendrën e Furnizimit Materialo Teknik), në rast se AK nuk ka ambjente mjaftueshëm për magazinim të mallit të kolauduar atëherë magazinimi i mallit do të bëhet në magazinat e Operatorit Ekonomik. Në të dyja rastet dorëzimi i këtij malli te përdoruesi - punonjësi i policisë në çdo strukturë vendore të policisë – deri në çdo komisariat/stacion policie, mbetet detyrë dhe përgjegjësi e Operatorit Ekonomik fitues dhe do të bëhet me mjetet e tij.

Shpërndarja e artikujve të uniformës do të realizohet sipas një procesi:

Bazuar në kërkesë porositë e dërguara nga njësitë shpenzuese për çdo punonjës policie, AK sektori përgjegjës për uniformat në DPPSH përgatit planin e shpërndarjes për çdo njësi (strukture policore) dhe ja dërgon OE.

Operatori Ekonomik fitues pas marrjes së planit për shpërndarje të artikujve të uniformave nga AK, do të realizojë dërgimin e mallrave të përdoruesi me pakot të personalizuara për çdo punonjës policie në çdo strukturë vendore të policisë – deri në çdo komisariat/stacion policie.

Administrimi i procesit do të kryhet sipas procedurave standarde të punës dhe akteve ligjore në fuqi.

8. **Garancitë**

Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet me deklaratën e garancisë. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë zyrtarisht që afati i garancisë për artikujt që do të furnizojë do të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit mbi 2 vjet.

Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e plotë të artikullit, pa pagesë, konform specifikimeve

teknike. Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë. Afati i garancisë fillon në momentin e shpërndarjes së uniformës.

| Nr | Artikujt që duhet të plotësojnë garancinë 1 vit | Artikujt që duhet të plotësojnë garancinë 2 vjet |
|---|---|---|
| 1 | Këmishë bojëqielli me mëngë të gjata për meshkuj | Xhup shërbimi ¾ me veshje të ngrohtë |
| 2 | Këmishë bojëqielli me mëngë të gjata për femra | Xhup shërbimi  me veshje të ngrohtë |
| 3 | Këmishë bojëqielli me mëngë të shkurtra për meshkuj | Kostumi i uniformës për punonjësit Meshkuj  ( Xhaketë + 2 Pantallona + 2 Kapele) |
| 4 | Këmishë bojëqielli me mëngë të shkurtra për femra | Kostumi i uniformës për punonjësit Femra ( Xhaketë + Pantallona + Fund + 2 Kapele ) |
| 5 | Kostumi doku stërvitje (Këmishë + Pantallona + 2 Kapele) | Pulovër e trikotuar jakë "V" |
| 6 | Bluzë me jakë të rrumbullakët me mëngë të gjata, | Kravatë e kostumit të uniformës |
| 7 | Bluzë me jakë të rrumbullakët me mëngë të shkurtëra, | Rripi i pantallonave të uniformës |
| 8 | Bluzë Polo me mëngë të gjata për patrullat | Rripi operacional multifunksional |
| 9 | Bluzë Polo me mëngë të shkurtra  për patrullat | Jeleku multifunksional |
| 10 | Pantallona doku rip stop | Pelerinë shiu |
| 11 | Kapele sportive doku Rip-Stop | Dorashka prej lëkure |
| 12 | Jelek me vizibilitet të lartë  patrullë rrugore (i gjelbër) | Pulovër e trikotuar me jakë të rrumbullakët |
| 13 | Jelek me vizibilitet të lartë patrullë e përgjithme (blu) | Pulovër e trikotuar me jakë gjysëm golf |
| 14 | Jelek me vizibilitet të lartë patrullë shqiponja (i kuq) | Kapuç leshi |
| 15 | Bluzë (Polo) për punonjësit e Policisë që kryejnë shërbime në plazhe | Pantallona verore për meshkuj |

| | | |
|---|---|---|
| 16 | Pantallona të shkurtra për punonjësit me shërbim pranë plazheve | Pantallona verore për femra |
| 17 | Dorashka ceremoniale | Fund për femra |
| 19 | Kostum shërbimi civil për zyrën e pritjes qytetarëve për meshkuj | Bluzë (Polo) me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit për meshkuj |
| 20 | Kostum shërbimi civil për zyrën e pritjes qytetarëve për femra | Bluzë (Polo) me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit për femra |
| 21 | Shall për femra | Kapele e uniformës verore |
| 22 | Këmishë me mëngë të gjata në shërbimin civil, për meshkuj për punonjësit e pritjes së qytetarëve. | Kostum motoçiklisti për punonjësit e Policisë Rrugore dhe Shqiponjat (Xhup, pantallona, 2 kapele tip sport dimërore) |
| 23 | Këmishë me mëngë të gjata në shërbimin civil, për femra për punonjësit e pritjes së qytetarëve. | Kostum patrulle për punonjësit e Policisë së Rendit dhe asaj Rrugore (Xhup, pantallona, 2 kapele tip sport dimërore) |
| 24 | Këmishë me mëngë të shkurtra në shërbimin civil, për meshkuj për punonjësit e pritjes së qytetarëve. | Xhup me vizibilitet të lartë (policia rrugore) |
| 25 | Këmishë me mëngë të shkurtra në shërbimin civil, për femra për punonjësit e pritjes së qytetarëve. | Aksesorë reflektivë për punonjësit e Policisë së Shtetit” (mëngore dhe mbulesë kapele) |
| 26 | Këpucë ceremoniale për femra | Dorashka motociklisti (Policia rrugore dhe njësia me motocikleta) |
| 27 | Këpucë ceremoniale për meshkuj | Jelek shpëtimi |
| 28 | Këpucë dimërore për femra dhe meshkuj | Jelek prezantues për punonjësit e Policisë së Shtetit-Hetimi Krimit |
| 29 | Këpucë verore për femra | Rripi i uniformës ceremoniale |
| 30 | Këpucë verore dhe meshkuj | Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata për meshkuj |
| 31 | Këpucë taktike, me qafë dimërore | Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata për femra |
| 32 | Këpucë taktike për patrulla në plazhe | Gradat Ceremoniale të Policisë së Shtetit |
| 33 | Këpucë taktike, me qafë verore | Gradat tubolare shërbimi të Policisë së Shtetit |

| | | |
|---|---|---|
| 34 | Këpucë taktike për struktura të veçanta | Gradat e Gjoksit, Numri i Identifikimit Shenja e Mbiemrit |
| 35 | | Stemat e Policisë dhe Shenja krahu shërbimi |
| 36 | | Logo Policia e Shtetit |
| 37 | | Kordonë ceremonial supi |
| 38 | | Kordonë ceremonial kapele |

**Shtojca 8**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

## LOTI I: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA, GRADA, STEMA DHE SHENJA PËR POLICINË E SHTETIT

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr. | Emërtimi i artikujve | Njësia matëse | Sasia e pritshme | Periudha e dorëzimit |
|---|---|---|---|---|
| **I** | **UNIFORMA BAZË** | | | |
| 1 | Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë) | copë | 400 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë) (xhup I shkurter) | copë | 9,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Kostum uniforme për Meshkuj (1 Xhaketë, 2 pantallona, 2 kapele) | komplet | 4,200 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Kostum uniforme për Femra / (1 Xhaketë, 2 pantallona, 2 kapele) | komplet | 345 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Pulovër e trikotuar jakë "V" | copë | 5,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Këmishë bojqelli me mënge të gjata meshkuj | copë | 30,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Këmishë bojqelli me mënge të gjata femra | copë | 1,800 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Kravatë uniforme blu ( kravatë e kostumit të uniformës) | copë | 6,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 9 | Rrip pantalloni uniforme | copë | 7,400 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 10 | Rrip multifunksional | copë | 3,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 11 | Jelek multifunksional | copë | 2,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 12 | Pelerina e shiut - Mushama shiu | copë | 6,050 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 13 | Doreza lëkure | Palë | 2,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 14 | Pulovër leshi e trikotuar -Pulover e trikotuar me jake rrumbullake | copë | 2,200 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 15 | Kapuç leshi I trikotuar - Kapuç leshi | copë | 1,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **II** | **UNIFORMA VERORE** | | | |
| 1 | Pantallona vere meshkuj | Palë | 8,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Pantallona vere femra | Palë | 200 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Këmishë bojëqelli me mëng të shkurtra, për meshkuj | copë | 35,800 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Këmishë bojëqelli me mëng të shkurtra, për femra | copë | 2,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Bluzë polo, me mëng të shkurtra për meshkuj | copë | 17,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Bluzë polo, me mëng të shkurtra për femra | copë | 1,700 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Kapele uniforme verore uniforme meshkuj | copë | 5,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **III** | **UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME** | | | |
| 1 | Kostum doku ripstop (kostum taktik) (këmishë blu me mëngë te gjata+ pantallona+2 kapele tip sport). | komplet | 10,400 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Bluzë pambuku me jakë të rrumbullakët mëngë të gjata | copë | 8,800 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Bluzë pambuku me jakë të rrumbullakët me mëngë tëshkurtra | copë | 6,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **IV** | **UNIFORMA TË VEÇANTA** | | | |
| a. | ***Uniforma dimërore dhe verore*** | | | |
| 1 | Kostum dimëror për ptrullat, motoçiklistat (xhup, pantallona, 2 kapele tip sport) | komplet | 250 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Kostumi dimëror për ptrullat (xhup, pantallona, 2 kapele sport) | komplet | 5,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Bluze polo, me mengë të gjata femra /meshkuj | copë | 21,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Bluza polo me mengë të shkurtera femra /meshkuj | copë | 34,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Pantallona doku | Palë | 23,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Kapele tip sport - kapele sportive për të gjithë strukturat | copë | 17,900 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Xhup fosforishent (pol rrugore) - Xhup me vizibilitet të lartë | copë | 250 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Mbulese kapele, mëngore fosforeshente,- aksesorë reflektiv | copë | 100 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 9 | Jelek me Vizibilitet të larte Pol rrugore (ngjyra e verdhe) ( aksesorë refletiv) | copë | 2,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 10 | Jelek me Vizibilitet të larte patrulle e përgjithshme (ngjyra e blu)- aksesorë reflektiv | copë | 5,900 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 11 | Jelek me Vizibilitet të larte patrulle e përgjithshme Shqiponja(ngjyra e kuqe) - aksesorë reflektiv | copë | 1,400 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 12 | Doreza motoçiklisti - Dorashka motorçiklisti | Palë | 50 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| b. | ***Uniforma e veçantë verore për punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në plazhe,*** | | | |
| 1 | Bluze me dy kopsa e bardhe | copë | 2,100 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Pantallona të shkurtra | Palë | 2,100 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **V** | **Uniforma për punonjësit e Policisë të Mjeteve Ujore:** | | | |
| 1 | Jelek shpëtimi (Mjete ujore) | copë | 150 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **VI** | **Uniforma e Prezantimit të Policisë së Hetimit të Krimit:** | | | |
| 1 | Jelek prezantues hetimi i krimit (jelek prezantues operacional ) | copë | 1,950 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **VII** | ***Uniforma ceremoniale*** | | | |
| 1 | Rrip ceremonial | copë | 36 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Kemishe ceremoniale me menge te gjata, meshkuj | copë | 1,400 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Kemishe ceremoniale me menge të gjata, femra | copë | 170 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Doreza ceremoniali ( dorashka ) | Palë | 112 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **VIII** | ***Uniforma prezantuese për zyrat e pritjes qytetareve*** | | | |
| 1 | Kostum I shërbimit civil për meshkuj (xhakete, pantallona) për zyrat e pritjes së qytetrateve | komplet | 10 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Kostum I shërbimit civil për femra (xhakete, fund ) për zyrat e pritjes së qytetarëve | komplet | 20 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Shall për femra | copë | 20 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Kemisha me m/gjata për shërbimin civil, Meshkuj | copë | 30 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Kemisha me m/gjata për shërbimin civil , femra | copë | 60 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Kemisha me menge te shkurtera për shërbimin civil, meshkuj | copë | 30 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Kemisha me menge te shkurtera për shërbimin civil, femra | copë | 100 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **I** | **Gradat e Policisë së Shtetit,** | | | |
| a | ***Gradët e mëdha të shërbimit spaleti Shërbimi*** | | | |
| 1 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Inspektor" | Palë | 16,800 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Nënkomisar " | Palë | 2,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Komisar " | Palë | 1,150 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Kryekomisar " | Palë | 750 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Drejtues " | Palë | 190 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Drejtues i Parë | Palë | 160 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Drejtues i Lartë " | Palë | 28 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Gradë e madhe spaleti shërbimi "Drejtues Madhor " | Palë | 8 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **b** | ***Gadë e madhe spaleti ceremoniale*** | | | |
| 1 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Inspektor" | Palë | 2,300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Nënkomisar " | Palë | 400 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Komisar " | Palë | 300 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Kryekomisar " | Palë | 200 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Drejtues " | Palë | 100 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Drejtues i Parë " | Palë | 40 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Gradë e madhe spaleti ceremoniali "Drejtues i Lartë | Palë | 20 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Gradë e madhe spaleti ceremonial "Drejtues Madhor | Palë | 8 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **c** | ***Gradë e vogël gjoksi*** | | | |
| 1 | Gradë e vogël gjoksi "Inspektor" | Copë | 11,800 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Gradë e vogël gjoksi "Nënkomisar " | Copë | 650 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Gradë e vogël gjoksi "Komisar " | Copë | 950 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Gradë e vogël gjoksi "Kryekomisar " | Copë | 580 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Gradë e vogël gjoksi "Drejtues " | Copë | 160 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Gradë e vogël gjoksi "Drejtues i Parë " | Copë | 120 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Gradë e vogël gjoksi "Drejtues i Lartë " | Copë | 28 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Gradë e vogël gjoksi "Drejtues Madhor " | Copë | 8 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **II** | ***Stema, Shenjat e Policisë së Shtetit*** | | | |
| 1 | Stema e Policisë së Shtetit | Copë | 24,275 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Shenjë e krahut POLICIA E RENDIT | Copë | 14,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Shenjë e krahut SHQIPONJA | Copë | 1,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Shenjë e krahut POLICIA RRUGORE | Copë | 2,700 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Shenjë e krahut POLICIA KUFIRIT DHE MIGRACIONIT | Copë | 6,900 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Shenjë e krahut "RENEA" | Copë | 556 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Shenjë e krahut "FKS" | Copë | 2,090 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Shenjë për kursantë/ studentë (Shenja e spaletit për kursantë/ studentë) | Copë | 2,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 9 | Shenjë gjoksi kursanti/ studenti | Copë | 2,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 10 | Shenjë gjoksi MBIEMËR | Copë | 1,100 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 11 | Shenjë gjoksi numër identifikimi ( numër RMIS) | Copë | 11,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 12 | Logo e Policisë së Shtetit | Copë | 500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| **III** | ***Kordonë për uniformën Ceremoniale ( kordonat dekorativë)*** | | | |
| 1 | Kordone Ceremoniali ( dekorativ) supi nga Inspektor - Kryekomisar | Copë | 1,875 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Kordone Ceremoniali (dekorativ) supi nga Drejtues - Drejtues i Parë | Copë | 70 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Kordone Ceremoniali (dekorativ) supi nga Drejtues i Lartë - Drejtues Madhor | Copë | 26 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Kordon ceremoniali (dekorativ) kapele Inspektor - Kryekomisar | Copë | 1,875 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Kordon ceremoniali (dekorativ) kapele Drejtues - Drejtues i Parë | Copë | 70 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Kordon ceremoniali (dekorativ) kapele Drejtues i Lartë - Drejtues Madhor | Copë | 26 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |

**Afatet e lëvrimit:** Prodhimi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që furnizimi me uniforma i punonjësve të policisë të bëhet sipas sezoneve të verës apo dimrit, në mënyrë që të mbulohen nevojat në kohë. Lëvrimi i artikujve të uniformave verore duhet të kryhet jo më vonë se data **1 Maj** të çdo viti dhe lëvrimi i uniformave dimërore duhet të kryhet jo më vonë se data **1 Tetor** të çdo viti.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruahet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë dhe jo me shume së 150 ditë nga lidhja e kontratës. Për çdo rast sasitë e kërkuara në kontatën e parë nuk do të jenë më tepër se 50 % e sasive të pritshme të vitit të parë.

## LOTI II: BLERJE DHE SHPËRNDARJE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr. | Emërtimi i artikujve | Njësia matëse | Sasia e pritshme | Periudha e dorëzimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Këpucë ceremoniale për meshkuj | Palë | 20 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 2 | Këpucë ceremoniale për femra | Palë | 4 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 3 | Këpucë dimërore për femra dhe meshkuj | Palë | 13,600 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 4 | Këpucë verore për meshkuj | Palë | 12,500 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 5 | Këpucë verore për femra | Palë | 558 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 6 | Këpucë taktike dimërore ( me qafë) | Palë | 12,530 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 7 | Këpucë taktike për patrullë në plazhe | Palë | 551 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 8 | Këpucë taktike verore me qafa | Palë | 1,800 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |
| 9 | Këpucë vere për shërbimet e veçanta (taktike verore për strukturat e veçanta) | Palë | 10,000 | 48 (dyzet e tetë) muaj MK |

**Afatet e lëvrimit:** Prodhimi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që furnizimi me uniforma i punonjësve të policisë të bëhet sipas sezoneve të verës apo dimrit, në mënyrë që të mbulohen nevojat në kohë. Lëvrimi i artikujve të uniformave verore duhet të kryhet jo më vonë se data **1 Maj** të çdo viti dhe lëvrimi i uniformave dimërore duhet të kryhet jo më vonë se data **1 Tetor** të çdo viti.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruahet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë dhe jo me shume së 150 ditë nga lidhja e kontratës. Për çdo rast sasitë e kërkuara në kontatën e parë nuk do të jenë më tepër se 50 % e sasive të pritshme të vitit të parë.

**LOTI I: BLERJE DHE SHPËRNDARJE UNIFORMA, GRADA, STEMA DHE SHENJA PËR POLICINË E SHTETIT**

**Shtojca 9**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 10.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit,* ***sipas shtojcës 10;***

*b. Sigurimin e Ofertës,* ***sipas Shtojcës 5;***

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit 1.** Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e

përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009(të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 1**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**2.** Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 120 (njëqind e njëzet) persona të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

**a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
***b.*** Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

***Shenim:*** Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më siper do të pa raqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**3.** Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

| **Nr.** | **Profesioni** | **Numri i punonjesve** |
|---|---|---|
| **1** | Inxhinier tekstili | 1 |
| 2 | Stilist/Modelist veshjesh | 2 |
| 3 | Pergjegjes prodhimi/drejtues linje | 2 |
| 4 | Prestarë veshjesh/teknik prestarie | 2 |
| 5 | Punetor te makinerive/ rrobaqepes | 98 |
| 6 | Punëtor hekuroses | 3 |
| 7 | Puntëtor paketues | 3 |
| 8 | Punëtor shpërndarje | 6 |
| 9 | Shofer | 3 |

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) *Për inxhinierin e tekstilit te paraqitet:*
- Diplomë që të vërteton kualifikimin profesional të mësipërm.
- Kontrate pune e vlefshme
- Inxhinieri i tekstilit duhet të kenë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

b) *Për stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje te paraqitet për secilin:*
- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional
- Kontrate pune e vlefshme.
- Stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

*c) Per punetor te makinerive/ rrobaqepes/hekuroses*
-kontrate pune e vlefshme
- duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

*ç Per puntorin paketues*
-kontrate pune e vlefshme

*d) per punetor shperndarje te paraqitet*
-kontrate pune e vlefshme

d*) Per punonjesit shofer te paraqitet:*
- Leje drejtimi mjeti e vlefshme.
- Kontrate pune e vlefshme.

-Listëpagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

**Shënim:** Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**4.** Operatori ekonomik duhet të disponoje makinerite si më poshtë:

-Makineri prerje automatike (sistemi (CUT)- minimalisht 1 copë
-Makina qepëse – minimalisht 98 copë
-Makineri hekurosje- minimalisht 3 copë

Për makineritë dhe pajisjet e deklaruara sipas kësaj pikë të provohet diponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- fatura shit - blerje **ose**

- kontrata shit - blerje **ose**
- kontratë qeraje **ose**
- kontratë huapërdorje.

**<u>Shënim:</u>** Kriteri nr. 4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

1) ISO 9001 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
2) ISO 14001 "Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
3) ISO 45001 "Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
4) ISO 28001 "Për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
5) ISO 22301 "Per sistemin e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

6.Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Çertifikatën OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vertetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuara të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente, do të pranohen raportet e testimit të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuara të certifikimit OEKO-TEX.

**7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) mostrat e artikujve sipas tabelës;
b) mostrat e lëndës së parë sipas tabelës;
**c)** skedat teknike sipas tabelës
ç) fletë analizë laboratorike të lëndës së parë sipas tabelës, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
d) deklaratat nga prodhuesi sipas tabelës

të cilat vërtetojnë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

-Skedat teknike, fletë analizë laboratorike të lëndës së parë dhe deklaratat, sipas kërkesave në tabelën e mëposhtme, do të paraqiten nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: Rr "Reshit Çollaku",Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Mostrat e artikujve, lëndës së parë dhe fletë analizat dhe deklarata do të paraqiten për artikujt si më poshtë:

## I. KOSTUMET

| Nr. | Emërtimi | Artikulli | Masa | Lënda e parë e mostrës | Dokumentacioni shoqërues |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ***Kostumi i uniformës për femra*** | pantallona | 42 | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | - Skedat teknike duhet të shoqërohet me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. -Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve |
| | | xhaketa | 42 | | |
| | | kapele | 54 | | |
| 2 | ***Kostumi i uniformës për meshkuj*** | pantallona | 54 | | |
| | | xhaketa | 54 | | |
| | | kapele | 57 | | |
| 3 | ***Kravata e kostumit të uniformës*** | kravata | | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| 4 | ***Pantallona verore për meshkuj dhe femra*** | pantallona meshkuj | 54 | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Pantallona femra | 42 | | |
| 6 | ***Kapela e uniformës verore për meshkuj*** | kapele për meshkuj | 57 | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| 7 | ***Kostumi i shërbimit civil për femra*** | xhaketa; | 42 | nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas |
| | | funde, | 42 | | |
| 8 | ***Kostumi i shërbimit civil për meshkuj*** | pantallona | 54 | | |
| | | xhaketa | 54 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |

## II. KËMISHAT

| Nr. | Emërtimi | Artikulli | Masa | Lënda e parë e mostrës | Dokumentacioni shoqërues |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | ***Këmishë bojëqielli me mëngë të gjata për meshkuj dhe femra*** | Këmisha meshkuj | 42 | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Këmisha femra | 40 | | |
| ***2*** | ***Këmishë bojëqielli me mëngë të shkurtra për meshkuj dhe femra*** | Këmisha | 42 | | |
| | | Këmisha | 40 | | |
| ***3*** | ***Këmisha ceremoniale me mëngë të gjata për meshkuj dhe femra*** | Këmisha | 42 | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>-Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve për kopsën xhemel |
| | | Këmisha | 40 | | |
| ***4*** | ***Këmishë me mëngë të gjata për meshkuj dhe femra në shërbimin civil*** | Këmisha meshkuj | 42 | | |
| | | Këmisha femra | 40 | | |
| **5** | ***Këmishë me mëngë të shkurtra për meshkuj dhe femra në shërbimin civil*** | Këmisha | 42 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | Këmisha femra | 40 | | |

## III. ARTIKUJ ME MATERIALE DOKU (RIPSTOP)

| Nr. | Emërtimi | Artikulli | Masa | Lënda e parë e mostrës | Dokumentacioni shoqërues |
|---|---|---|---|---|---|
| *1* | ***Kostumi taktik*** | Këmishë dhe pantallona | M | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear, për secilin lloj tekstili. | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>- Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve për stemën plastike |
| *2* | ***Kapele sportive*** | Kapele | M | | |
| *3* | ***Pantallona doku (verore)*** | Pantallona për femra | 44 | | |
| | | Pantallona për meshkuj | 52 | | |
| *4* | ***Pantallona të shkurtra*** | Pantallona për femra | 44 | | |
| | | Pantallona për meshkuj | 52 | | |

## IV. ARTIKUJ ME MATERIAL TRIKOTAZH

| Nr. | Emërtimi | Artikulli | Masa | Lënda e parë e mostrës | Dokumentacioni shoqërues |
|---|---|---|---|---|---|
| *1* | ***Bluzë pambuku me mëngë të gjata me jakë rrumbullake*** | Bluza për meshkuj. | L | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| *2* | ***Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me jakë rrumbullake*** | bluza për femra. | L | | |
| *3* | ***Bluzë polo me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit*** | bluza për meshkuj. | L | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | bluza për femra | L | | |
| *4* | ***Bluzë polo me mëngë të gjata për patrullat e Policisë së Shtetit*** | bluza për meshkuj. | L | | |
| | | bluza për femra. | L | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | ***Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat e Policisë së Shtetit*** | bluza për meshkuj | L | | |
| | | bluza për femra | L | | |
| 6 | ***Bluzë me mëngë të shkurtra për punonjësit me shërbim pranë plazheve*** | bluza për meshkuj. | L | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | bluza për femra | L | | |
| 7 | ***Pulovër i trikotuar me jakë "V"*** | Pulovra për meshkuj | L | Nje pjesë tekstili të trikotuar me përmasë 0.5 x 0.5 m, i punuar me dy llojet e thurjeve për punimin e pulovrit, llastik 1:1 dhe interlock. | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Pulovra përfemra | L | | |
| 8 | ***Pulovër i trikotuar me jakë rrumbullake*** | Pulovra për meshkuj | L | | |
| | | Pulovra për femra | L | | |
| 9 | ***Kapuç leshi*** | kapuç | L | | |

## V. XHUPA

| Nr. | Emërtimi | Artikulli | Masa | Lënda e parë e mostrës | Dokumentacioni shoqërues |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ***Xhup i shkurtër*** | Xhup për meshkuj | M | 1nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Xhup për femra | M | | |
| 2 | ***Xhup (3/4) treçereksh*** | Xhup për meshkuj | M | | |
| | | Xhup për femra | M | | |
| 3 | ***Kostumi dimëror për motoçiklistët*** | Pantallona për meshkuj | 54 | 1 nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Xhup për meshkuj | 54 | | |
| 4 | ***Kostumi dimëror për patrullat*** | Pantallona për femra | 44 | | |
| | | Xhup për femra | 44 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| ***5*** | ***Kapele sportive dimërore*** | kapele | L | | - Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve për stemën plastike. |
| ***6*** | ***Dorashka motoçiklisti*** | dorashka për meshkuj | L | 1 nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | dorashka për femra | M | | |
| 8 | ***Xhup me vizibilitet të lartë*** | Xhup për meshkuj | M | 1 Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Xhup për femra | L | | |
| ***9*** | ***Mushama shiu*** | Mushama | M | 1 nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |

## VI. AKSESORË

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Artikulli** | **Masa** | **Lënda e parë e mostrës** | **Dokumentacioni shoqërues** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | ***Aksesorë reflektivë*** | Jelekë blu | M | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Jelekë të gjelbër | M | | |
| | | Jelekë të kuq | M | | |
| | | Mbulesa për kapelen e uniformës për meshkuj | 2 | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | - Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Mbulesa për kapelen e uniformës për femra | 2 | | |
| | | Mëngore | Masë unike | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **2** | ***Dorashka ceremoniale*** | Dorashka ceremoniale për meshkuj | L | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | Dorashka ceremoniale për femra | M | | |
| 3 | | Dorashka për meshkuj | XL | 1 kampion të lëkurës *meshinë deleje* 30 x 30 cm. | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | ***Dorashka prej lëkure*** | Dorashka për femra | L | | |
| ***4*** | ***Jelek operacional multifunksional*** | Jelekë | II | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear. | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| ***5*** | ***Jelek shpëtimi*** | Jelekë | M | nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skeda teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| ***6*** | ***Jelek prezantues POLICIA KRIMINALE*** | Jelekë | II | Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| ***7*** | ***Rrip për uniformën ceremoniale*** | Rrip | L | Nje kampion telatinë natyrale 30 x 30 cm | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>- Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | ***Rripi operacional multifunksional*** | Rrip | II | 1 nje kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| ***9*** | ***Rripi i pantallonave*** | Rripa pantallonash për meshkujt | XL | Nje kampione telatinë natyrale 30 x 30 cm | Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>-Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve |
| | | Rripa pantallonash për femra | L | | |

## VII. GRADAT, STEMAT DHE KORDONAT

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Artikulli** | **Rangu** | **Lënda e parë e mostrës** | **Dokumentacioni shoqërues** |
|---|---|---|---|---|---|
| ***1*** | ***"Gradat shërbimit të Policisë së Shtetit"*** | Grada shërbimi | - Inspektor<br>- Kryekomisar<br>- Drejtues<br>- Drejtues i lartë | 1 kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear në gjerësinë e tekstilit. | -Skeda teknike të tekstilit duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>-Skeda teknike të elementëve plastikë duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi<br>- Skeda teknike të elementëve metalikë duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi<br>-Skeda teknike të secilit produkt të gatshëm (Grada |
| ***2*** | ***"Gradat e gjoksit, Numri i Identifikimit RMIS dhe Shenja e Mbiemrit"*** | Grada gjoksi | - Inspektor<br>- Nënkomisar<br>- Drejtues i parë<br>- Drejtues Madhor | | |
| | | Numri i | identifikimit RMIS | | |
| | | Shenja e | mbiemrit | | |
| ***3*** | ***"Gradat Ceremoniale të Policisë së Shtetit"*** | Grada ceremoniale | - Inspektor<br>- Komisar<br>- Drejtues | | |

<table>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>- Drejtues Madhor</td><td></td><td>Shërbimi, Grada Gjoksi, Grada Ceremoniale).</td></tr>
<tr><td rowspan="3">4</td><td rowspan="3">“Stema e Policisë dhe shenjat dalluese të krahut për punonjësit e Policisë së Shtetit"</td><td colspan="2">Stema e Policisë së Shtetit</td><td></td><td rowspan="3">-Skeda teknike të plastikës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi<br>-Skeda teknike të produktit të gatshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Logo e Policisë së Shtetit</td><td></td></tr>
<tr><td>Shenja sipas çdo shërbimi të Policisë së Shtetit</td><td>POLICIA E RENDIT<br>SHQIPONJA<br>FKS<br>RENEA<br>POLICIA RRUGORE<br>POLICIA KUFITARE</td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="6">5</td><td rowspan="6">Kordonë dekorativë</td><td>kordonë ceremonialë për kapelën.</td><td rowspan="2">Drejtues–Drejtues Madhor</td><td rowspan="6">1 (një) pjesë me gjatësi 50 cm nga secili shirit që është përdorur për realizimin e kordonëve</td><td rowspan="6">-Skeda teknike të kordonave duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi<br>-Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve</td></tr>
<tr><td>kordonë ceremonialë, për supin</td></tr>
<tr><td>kordonë ceremonialë për kapelën.</td><td rowspan="2">Reparti Ceremonial dhe Trupa Ceremoniale në Drejtoritë Vendore</td></tr>
<tr><td>kordonë ceremonialë, për supin</td></tr>
<tr><td>kordonë ceremonialë për kapelën.</td><td rowspan="2">Strukturat e Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit (me ngjyrë bojëqielli).</td></tr>
<tr><td>kordonë ceremonialë, për supin</td></tr>
</table>

**Mënyra e dorëzimit të mostrave:**

Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet nje moster. Mostra duhet të jetë qepur me fije me ngjyrë të kuqe, Artikujt duhet të kenë të qepur / montuar të gjithë aksesorët, sipas specifikimeve teknike. Kampionet / mostrat duhet të kenë të qepur etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar dhe të jenë me ambalazhim fabrike.

Kampionet / mostrat duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme me numrin rendor përkatës, të fiksuar në artikull dhe të vulosur nga ofertuesi, sipas numrit rendor të tabelave të mësipërme.

Ne lidhje me paraqitjen e mostres se tekstilit, sqarojme se si moster duhet te paraqitet cope nga tekstili i kryesor i veshjes-jo psh astari apo tekstili dytesor. Kjo vlen edhe per flete analizen dhe skeden teknike, te cilat duhet te jene te tekstilit kryesor te veshjes.

**Mos dorëzimi i kampioneve / mostrave sipas kërkesave të sipër përmendura përbën kusht për skalifikim.**

**8.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

| Mjete | Sasia | Gjendja |
|---|---|---|
| Mjet për transportin e mallrave | 3 (tre) | Pronësi / Me qera / Huapërdorje |

a)Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit/(per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)
b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerase, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

***Shenim:*** Kriteri nr.8 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më siper do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

***Shënim:*** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetem ne lotin/et ne te cilin/et oferta e tij eshte ekonomikisht me e favorshme.

**Shënim:** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Shënim:** Bazuar në nenin 82 pika 4 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

**Shënim:** Bazuar në nenin 14 pika 2 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i

kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. *Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## LOTI II: BLERJE DHE SHPËRNDARJE KËPUCË PËR POLICINË E SHTETIT

**Shtojca 9**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 10.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit II.** Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**1.**Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit II**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**2.** Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 82 (tetëdhjetë e dy) persona të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

**a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
***b)*** Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

***Shenim:*** Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më siper do të pa raqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**3.** Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

| **Nr.** | **Profesioni** | **Numri i punonjesve** |
|---|---|---|
| 1 | Kimist | 1 |
| 2 | Stilist/Modelist këpucësh | 1 |
| 3 | Pergjegjes prodhimi/drejtues linje | 2 |
| 4 | Prestar lëkure/teknik prestarie | 3 |
| 5 | Punonjes per montimin e kepuceve | 2 |
| 6 | Punonjës makinerish qepjen e kepuceve | 60 |
| 7 | Punonjës paketimi | 2 |
| 8 | Punonjës për llusrtimin/lyerje të këpucëve | 2 |
| 9 | Shofer | 3 |
| 10 | Punonjes për shperndarjen | 6 |

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) *Për kimistin te paraqitet:*
- Diplomën, që të vërteton kualifikimin profesional të mësipërm.
- Kontrate pune e vlefshme
- Kimisti duhet të kenë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

b) *Për Stilist/modelist këpucësh, prestar lëkure/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/*drejtues *linje* te paraqitet:
- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional
- Kontrate pune e vlefshme.
- Stilist/modelist këpucësh, prestar lëkure/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

c) *Për Punonjës makinerish/ punonjes per qepjen dhe montimin e kepuceve te paraqitet:*
- Kontrate pune e vlefshme.
- Këta punonjësduhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

*ç) Për punonjës paketimi të paraqitet:*
- Kontrate pune e vlefshme

d) *Punonjës për llustim/lyerje të këpucëve të paraqitet:*
- Kontrate pune e vlefshme

dh) *Për punonjesit per shperndarje, te paraqitet:*
- Kontratë pune e vlefshme.

f) *Per punonjesit shofer te paraqitet:*
- Leje drejtimi mjeti e vlefshme.
- Kontrate pune e vlefshme.

-Listëpagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

**Shënim:** Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**4.** Operatori ekonomik duhet të disponoje makinerite si më poshtë:

-makineri prerje automatike - minimalisht 1 copë
-makina qepëse – minimalisht 60 copë
-makineri injektimi dhe montimi (montimi i pjesës së sipërme me pjesën e poshtme të këpucës)- minimalisht 1 copë

Për makineritë dhe pajisjet e deklaruara sipas kësaj pikë të provohet diponueshmëria e tyre në një n mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- fatura shit - blerje **ose**
- kontrata shit - blerje **ose**
- kontratë qeraje **ose**
- kontratë huapërdorje.

**Shënim:** Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

a) ISO 9001 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
b) ISO 14001 "Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
c) ISO 45001 "Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
d) ISO 28001 "Për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
e) ISO 22301 "Per sistemin e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit" ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

6.Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Çertifikatën OEKO-TEX për lëkurën (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vertetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuara të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën ose ekuivalente. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën ose ekuivalente, do të pranohen raportet e testimit të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e

Shqipërisë, të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuara të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën.

**7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) mostrat e artikujve sipas tabelës;
b) mostrat e lëndës së parë sipas tabelës;
**c)** skedat teknike sipas tabelës
ç) fletë analizë laboratorike të lëndës së parë sipas tabelës, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
d) Çertifikatat e konformiteti sipas tabelës, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë'

të cilat vërtetojnë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit

-Skedat teknike, fletë analizë laboratorike të lëndës së parë dhe çertifikatat e konformitetit, sipas kërkesave në tabelën e mëposhtme, do të paraqiten nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: Rr "Reshit Çollaku",Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Mostrat e artikujve, lëndës së parë, fletë analizat dhe çertifikimet që do të paraqiten për artikujt si më poshtë:

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Artikulli** | **Masa** | **Lënda e parë e mostrës** | **Dokumentacioni shoqërues** |
|---|---|---|---|---|---|
| *1* | ***Këpucë taktike me qafë, verore për punonjësit e Policisë së Shtetit.*** | këpucë për meshkuj | 44 | Nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | -Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347- 2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës (e jashtme, e ndermjetme, e brendeshme)duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | këpucë për femra | 38 | nje copë tekstil teknik të përdorur për ndërtimin e këpucës 0.5 m | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | -Skeda teknike e tekstilit duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| 2 | ***Këpucë taktike me qafë, dimërore, për punonjësit e Policisë së Shtetit.*** | këpucë për meshkuj | 45 | Nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | -Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347- 2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet.<br>- Skedat teknike të lëkurës dhe shollës (e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme) duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | këpucë për femra | 40 | | |
| 3 | ***Këpucë taktike me qafë të shkurtër, verore, për strukturat e veçanta.*** | këpucë për meshkuj | 43 | Nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | -Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet.<br>- Skedat teknike të lëkurës dhe shollës (e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme)duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>-Skeda teknike e tekstilit duhet të shoqërohen me Fletë |
| | | këpucë për femra | 39 | Nje copë tekstil teknik të përdorur për ndërtimin e këpucës 0.5 m | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| 4 | ***Këpucë taktike, verore, për punonjësit e Policisë së Shtetit me shërbim në plazhe.*** | këpucë për meshkuj | 42 | nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | - Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347- 2012 O2 HRO HI ËR FO SRC ose ekuivalentet.<br>Skedat teknike të lëkurës dhe shollës (e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme) duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.<br>-Skeda teknike e tekstilit duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | këpucë për femra | 38 | nje copë tekstil teknik të përdorur për ndërtimin e këpucës 0.5 m | |
| 5 | ***Këpucë dimërore për femra dhe për meshkuj për punonjësit e Policisë së Shtetit*** | këpucë për meshkuj | 44 | nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | - Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 të modelit B - O2 CI ËR FO SRC ose ekuivalentet.<br>- Skedat teknike të lëkurës dhe shollës(e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme) duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas |
| | | këpucë për femra | 40 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| *6* | ***Këpucë verore për meshkuj për punonjësit e Policisë së Shtetit*** | këpucë për meshkuj | 42 | Nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | - Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 të modelit A - O2 ËR FO SRC ose ekuivalentet.<br>- Skedat teknike të lëkurës dhe shollës (e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme) duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| *7* | ***Këpucë verore për femra për punonjëset e Policisë së Shtetit*** | këpucë për femra | 38 | Nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | - Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 O2 ËR FO SRC ose ekuivalentet.<br>-Skedat teknike të lëkurës dhe shollës(e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme) duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| *8* | ***Këpucë ceremoniale për meshkuj për punonjësit e Policisë së Shtetit*** | këpucë për meshkuj | 41 | nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës(e jashtme, e ndermjetme dhe e brendshme) duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| ***9*** | ***Këpucë ceremoniale për femra për punonjëset e Policisë së Shtetit*** | këpucë për femra | 38 | Nje pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | -Skedat teknike të lëkurës, astarit, shollës dhe përforcueses së shollës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi. |
| | | | | nje pjesë të astarit të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm | |

**Mënyra e dorëzimit të mostrave:**
Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet në nje kampion / moster i cili duhet të jetë i qepur me fije me ngjyrë të kuqe. Artikujt duhet të kenë të qepur / montuar të gjithë aksesorët, sipas specifikimeve teknike. Kampionet / mostrat duhet të kenë të qepur/ngjitur etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar dhe të jenë me ambalazhim fabrike.
Kampionet / mostrat duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme me numrin rendor përkatës, të fiksuar në artikull dhe të vulosur nga ofertuesi, sipas numrit rendor të tabelave të mësipërme.

**Mos dorëzimi i kampioneve / mostrave sipas kërkesave të sipër përmendura përbën kusht për skualifikim.**

**8.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

| **Mjete** | **Sasia** | **Gjendja** |
|---|---|---|
| Mjet për transportin e mallrave | 3 (tre) | Pronësi / Me qera / Huapërdorje |

a)Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit/(per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)
b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerase, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

***Shenim:*** Kriteri nr.8 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më siper do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

***Shënim:*** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetem ne lotin/et ne te cilin/et oferta e tij eshte ekonomikisht me e favorshme.

**Shënim:** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Shënim:** Bazuar në nenin 82 pika 4 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

**Shënim:** Bazuar në nenin 14 pika 2 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. *Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*

**Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorezohen vetëm nga operatori ekonomik që është shpallur fitues:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 10.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------ |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | -------------------------------------------------------- --- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| Deklarata |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: |
| ________________________________________<br>________________________________________ |

| |
|---|
| etj.<br><br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ________________________________________________<br><br>______________________________________________________________________________<br><br>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br><br>_________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_______________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br><br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_______________________________________________ |
| Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*______________________________________<br><br>___________________________________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. |
| *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br><br>____________________________________________________________________________<br><br>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_______________________________________<br><br>_____________________________________________________________________________ |

| |
|---|
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _______________________________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |

**B: DEKLARATA**

**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

| |
|---|
| Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se**:<br><br>Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.<br><br>Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër[6].<br><br>Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:<br><br>1. çmimet;<br>2. metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>3. qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,<br>4. paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.<br><br>Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.<br><br>Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj. |

**C: DEKLARATA**

**Mbi Konfliktin e Interesit**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: |

[6] *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.
- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.
-

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit**.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA**

**Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

| **Deklarata** |
|---|

| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: |
|---|
| • Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË**

**Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | Punonjës<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>Profili i punonjësve<br><br>___________________________________________<br><br>Makineri e mjete |

| | |
|---|---|
| | Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| **Emri, Mbiemri**_______________<br><br>**Firma** ______________________<br><br>**Vula**________________________<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës** ________________ | |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- **Në procedurat e prokurimit me një faze, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.**

- **Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.**

- **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.**

- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**

**Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

**Shtojca 11**

**Formulari i Njoftimit të Skualifikimit**[7]

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit te njoftimit te fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

[7] *Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore*

**Shtojca 12**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**Data**

**Drejtuar:**

**Operatorit Ekonomik (OE)** □ ____ **ose**
*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □
*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat:* ________________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:________________

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*______

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.__________________________________ ___________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.________________________________ __________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Etj.________________________________________________________________________________

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________ totali i pikëve të marra____________*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.________________________________________________________________________________

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________ totali i pikëve të marra________________*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.____________________________________________________________

* * *

**Lista e operatorëve ekonomikë të skualifikuar:**

1.________________________________ ______________ __________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.________________________________ ____________ __________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____________ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**Shtojca 13**

**[***Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor***]**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data]*

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)** □_____ **ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat:* ________________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:________________

Lloji i Procedurës së prokurimit:___________

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: _____________________________

[8]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *[Data] [Numri]*_____________________________

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

[8] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Etj.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1.______________________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________ totali i pikëve të marra________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.___________________________________ ______________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it* Vlera

Vlera ______________________________ totali i pikëve të marra________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.

**Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:**

1.___________________________________ ________________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ _____________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO☐

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]**

**Shtojca 14**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR , PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**Data**

**Drejtuar:**

**Operatorit Ekonomik (OE)** □ ____ **ose**
*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □
*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat:* ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

* * *

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:________________

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*______

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

1.________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.____________________________

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues:**

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave_________________________________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave___________________________________________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.____________________________

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit e mëposhtëm:**

1.__________________________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.___________________________________ __________________ ________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

**Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i suksesshëm:**

1.___________________________________ _______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave __________*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.___________________________________ _______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave______ *(_e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

Etj.________________________________

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**Shtojca 15**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data]*

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)** □ ____ **ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat*: ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit (___________________________

[9]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit,*[Data] [Numri]*___________________________

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

**Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:**

[9] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.____________________________

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues:**

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave________________________________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave________________________________________________________________________
*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj._____________________________

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit e mëposhtëm:**

1.__________________________________ _______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ __________________ ________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

**Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:**

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave______________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave ______________________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________
Etj.______________________________

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [*emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor* ] brenda ____________ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO □ JO □

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]**

## Shtojca 16

*(Shtojce për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*)

**FORMULARI I ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri__________________

Adresa__________________

Tel/Faks_________________

E-mai__________________

Ueb-faqe____________________________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ___________________________________________________**

**3. Numri i Referencës se procedures/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës _______________________________________________________**

**5. Fondi Limit______________________________________________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

□*në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
□*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
□*konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
□*për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*
□*kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;*
□*kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.*

**7. Informacion shtesë**
_____________________________________________________________________________________
_____________________________________________________

Me publikimin e këtij formulari, nisin afatet e ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të Ligjit 162/2020 "Per prokurimin publik", të ndryshuar.

## Seksioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 18: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Draftmarrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 21: Draftmarrëveshja kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

**Shtojca 17**

# Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1.1 Kontrata**

**1.1.1.1** “Kontrata” do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** “Çmimi i Kontratës” do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 25.

1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Mallrave objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7 "Vizatimet" do të thotë vizatimet e Mallrave, siç janë përfshirë në Kontratë, dhe çdo vizatim shtesë dhe i modifikuar i lëshuar nga (ose në emër dhe për llogari të) Blerësit në përputhje me Kontratën.

1.1.1.8 "Katalog" do të thotë një "libër" që përmban listën e produkteve/mallrave përfshirë përshkrimet e cilësive/specifikimeve, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

1.1.1.9 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.10 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.11 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.12 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**1.1.2 Palët e Kontratës**

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Mallrave objekt kontrate.

1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që furnizon Mallrat objekt kontrate.

1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të Mallrave ose Shërbimeve të Lidhura me to.

**1.1.3 Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi**

1.1.3.1 "Test i Pranimit" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me Specifikimet për qëllimin e pranimit të Mallrave.

1.1.3.2 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Mallrat**

1.1.4.1 "Mallra" do të thotë të gjitha mallrat, lënda e parë, makineritë dhe pajisjet dhe / ose materialet e tjera që Furnizuesit duhet t'i furnizojnë Blerësit sipas Kontratës.

1.1.4.2 "Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me furnizimin e Mallrave, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

**1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 22 "Forca Madhore".

**1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 10 "Sigurimi i Kontratës".

**1.1.5.4** "Vendi i dorëzimit të Mallrave", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**1.1.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

**1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK

**1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

**1.2.1** Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Inkotermat**

(a) "Inkotermat" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

(b) Përveçse kur nuk është në përputhje me ndonjë dispozitë të Kontratës, kuptimi i çdo termi tregtar dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve në të do të jenë siç përshkruhet nga Inkotermat.

(c) Inkotermat, kur përdoren, rregullohen nga rregullat e përshkruara në botimin aktual të Inkotermave, të specifikuara në KVK, dhe të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

**1.2.3 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të

kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

### 1.2.4 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

### 1.2.5 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

## 1.3 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

## 1.4 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

## 1.5 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

## 1.6 Hartimi i Kontratës

**1.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentet e Tenderit.

**1.6.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

## 1.7 E drejta e autorit

**1.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

## 1.8 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Mallrave të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

## 1.9 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës 1.9 (a) këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar Nenin 7.1.

## 1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

**1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

**2.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**2.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3 Njoftimet**

**3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**3.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4 Objekti i Furnizimit**

**4.1** Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5 Dorëzimi**

**5.1** Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

**6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7 Çmimi i Kontratës**

**7.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

**Neni 8 Kushtet e Pagesës**

**8.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

**8.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

**8.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

**8.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 9 Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera**

**9.1** Për Mallrat e prodhuara jashtë vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Blerësit.

**9.2** Për Mallrat e prodhuara brenda vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara tek Blerësi.

**9.3** Nëse në vendin e Blerësit, mund të jetë i disponueshëm për Furnizuesin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Blerësi duhet t'i krijojë mundësi Furnizuesit të përfitojë nga këto lehtësira.

**Neni 10 Sigurimi i Kontratës**

**10.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

**10.2** Në përputhje me Nenin 10.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

**10.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

**10.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 11 Nënkontraktimi**

**11.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

**11.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit

**11.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 12 Specifikimet dhe Standardet**

**12.1** Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura të jenë në përputhje me Kërkesat Teknike, siç specifikohet në Dokumentet e Tenderit.

Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Blerësi, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Furnizuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Blerësin për të.

Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Blerësi dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 23 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127.

**Neni 13 Paketimi dhe Dokumentet**

**13.1** Furnizuesi siguron paketimin e mallrave siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin ose përkeqësimin e tyre gjatë transportit në destinacionin e tyre përfundimtar, siç përshkruhet në Kontratë. Gjatë transportit, paketimi duhet të jetë i tillë që t'i rezistojë ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme, kripës dhe reshjeve dhe kushteve të magazinimit. Madhësia dhe peshat e kutisë së paketimit do të marrin parasysh, kur është e përshtatshme, largësinë e destinacionit përfundimtar të Mallrave.

**13.2** Paketimi, shënjimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në përputhje me kërkesat e veçanta siç parashikohen shprehimisht në Kontratë, përfshirë kërkesat shtesë, nëse ka, të specifikuara në KVK, dhe në çdo kërkesë tjetër nga Blerësi.

**Neni 14 Siguracioni**

**14.1** Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me prodhimin ose blerjen, transportin, magazinimin dhe dorëzimin, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.

**Neni 15 Transporti**

**15.1** Përveçse kur përcaktohet ndryshe në KVK, përgjegjësia për organizimin e transportit të Mallrave do të jetë në përputhje me Inkotermat e zbatueshme.

**Neni 16 Inspektimet dhe testet**

**16.1** Furnizuesi do të kryejë me shpenzimet e veta dhe pa asnjë kosto për Blerësin, të gjitha testet dhe / ose inspektimet e tilla të Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to siç specifikohet në KVK.

**16.2** Inspektimet dhe testet mund të kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, në pikën e dorëzimit, dhe / ose në destinacionin përfundimtar të Mallrave, ose në një vend tjetër në vendin e Blerësit siç përcaktohet në KVK. Nëse kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, të gjitha lehtësitë dhe ndihma e arsyeshme, duke përfshirë aksesin tek vizatimet dhe të dhënat e prodhimit, do t'u dorëzohen inspektorëve pa pagesë për Blerësin.

**16.3** Përfaqësuesit e caktuar të Blerësit kanë të drejtë të marrin pjesë në testet dhe / ose inspektimet e përmendura në Nenin 16.2, me kusht që Blerësi të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet e tij të kryera në lidhje me një pjesëmarrje të tillë duke përfshirë, por pa u kufizuar, të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit.

**16.4** Kurdoherë që Furnizuesi është i gatshëm të kryejë ndonjë test dhe inspektim të tillë, ai do t'i bëjë një njoftim të arsyeshëm paraprak, Blerësit, duke përfshirë vendin dhe kohën. Furnizuesi do të marrë nga çdo Palë e tretë përkatëse ose prodhues çdo leje ose pëlqim të nevojshëm për t'i mundësuar Blerësit ose përfaqësuesit të tij të caktuar të marrë pjesë në test dhe / ose inspektim.

**16.5** Blerësi mund të kërkojë nga Furnizuesi të kryejë çdo test dhe / ose inspektim që nuk kërkohet nga Kontrata, por konsiderohet i nevojshëm për të verifikuar nëse karakteristikat dhe performanca e Mallrave përputhen me kodet dhe standardet e Specifikimeve Teknike sipas Kontratës. Blerësi do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Nëse një test dhe / ose inspektim i tillë pengon progresin e prodhimit dhe / ose kryerjen nga ana e Furnizuesit të detyrimeve të tjera të tij sipas Kontratës, Blerësi do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.

**16.6** Furnizuesi do t'i sigurojë Blerësit një raport të rezultateve të çdo testi dhe / ose inspektimi të tillë.

**16.7** Blerësi mund të refuzojë çdo Mall ose ndonjë pjesë të tij që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është në përputhje me Specifikimet. Furnizuesi do të ndreqë ose zëvendësojë Mallrat e refuzuar apo pjesë të tyre ose do të bëjë ndryshimet e nevojshme për të përmbushur specifikimet pa ndonjë kosto për Blerësin, dhe do të përsërisë testin dhe / ose inspektimin, pa asnjë kosto për Blerësin, pasi të njoftojë në përputhje me Nenin 16.4.

**16.8** Furnizuesi bie dakord që ekzekutimi i një testi dhe / ose inspektimi i Mallrave ose ndonjë pjese të tyre, nuk e shkarkojnë Furnizuesin nga garancitë ose detyrimet e tjera sipas Kontratës.

**Neni 17 Dëmet e likujduara**

**17.1** Dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 18 Garancia**

**18.1** Furnizuesi garanton që Mallrat nuk kanë defekte që vijnë nga ndonjë veprim ose mosveprim i Furnizuesit ose që vijnë nga skicimi, materialet dhe punimi nën përdorimin normal në kushtet që mbizotërojnë në vendin e destinacionit përfundimtar.

**18.2** Blerësi përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi Mallrat, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë dorëzuar dhe pranuar në destinacionin përfundimtar të përshkruar në KVK.

**18.3** Blerësi do të njoftojë Furnizuesin duke treguar natyrën e defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se dhjetë ditë nga zbulimi. Blerësi do të sigurojë të gjitha mundësitë që Furnizuesi të inspektojë defekte të tilla.

**18.4** Pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi Mallrat ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Blerësin.

Nëse pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Blerësi mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Furnizimit. Në çdo rast, Blerësi mund të vendosë që të njoftojë Furnizuesin për ndërprerjen e Kontratës.

**Neni 19 Zhdëmtimi i Patentës**

**19.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) instalimit të mallrave nga Furnizuesi ose përdorimit të mallrave në vendin e dorëzimit të Mallrave;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Mallrat.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Mallrat ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

**19.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 19.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

**19.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte

në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

**Neni 20 Kufizimi i Përgjegjësisë**

**20.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të pajisjeve me defekt, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 21 Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

**21.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 22 Forca madhore**

**22.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**22.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**22.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 23 Modifikimi i Kontratës**

**23.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**23.2** Blerësi mund t'i paraqesë kërkesë në çdo kohë Furnizuesit, të bëjë modifikime brenda objektit të përgjithshëm të Kontratës në një ose më shumë nga kushtet si vijon:

(a) vizatimet, skicat ose specifikimet, ku Mallrat që do të furnizohen sipas Kontratës duhet të prodhohen posaçërisht për Blerësin;

(b) mënyra e dërgesës ose paketimit;

(c) vendin e dorëzimit; dhe

(d) Shërbimet e Lidhura që do të ofrohen nga Furnizuesi.

**23.3** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

**23.4** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 24 Zgjatja e afatit**

**24.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë dërgimin në kohë të Mallrave ose përfundimin e Shërbimeve të Lidhura në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

**24.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 22, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 25 Ndërprerja e Kontratës**

**25.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**25.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 25.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të dorëzojë ndonjë ose të gjitha Mallrat brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 24; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**25.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të

cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**25.4** **Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Mallrat e pranuara dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26 Kufizimet e Eksportit**

**26.1** Pavarësisht nga çdo detyrim sipas Kontratës për të përfunduar të gjitha formalitetet e eksportit, çdo kufizim eksporti që i atribuohet Blerësit, vendit të Blerësit ose përdorimit të mallrave ose shërbimeve që do të furnizohen, të cilat rrjedhin nga rregulloret tregtare nga një vend që furnizon ato mallra ose shërbime, dhe të cilat në mënyrë të konsiderueshme e pengojnë Furnizuesin për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës, do ta shkarkojnë Furnizuesin nga detyrimi për të ofruar dërgesa ose shërbime, gjithnjë me kusht që Furnizuesi të demonstrojë në mënyrë të kënaqshme për Blerësin që i ka përfunduar të gjitha formalitetet në kohën e duhur, duke përfshirë aplikimet për leje, autorizime dhe licenca të nevojshme për dërgimin e mallrave ose shërbimeve sipas kushteve të Kontratës.

**Neni 27 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**27.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**27.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Shtojca 18**

# Kushtet e Veçanta të Kontratës

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

**Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**

**1.1** Blerësi është: ***[vendos emrin e Blerësit ]***

Adresa: ________________________________________________________________

Telefoni: _______________________________________________________________

Numri i faksit: ___________________________________________________________

E-mail: _________________________________________________________________

**1.2** Furnizuesi është: ***[vendos emrin e Furnizuesit]***

Adresa: ________________________________________________________________

Telefoni: _______________________________________________________________

Numri i faksit: ___________________________________________________________

E-mail: _________________________________________________________________

*Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës*.

**1.3** Gjuha për komunikimet është ***[specifiko gjuhën për komunikime]****:*

Gjuha është: ***[specifiko gjuhën]***

**Neni 2 Sigurimi i Kontratës**

**2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së saj) duhet të ofrohet nga Furnizuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**2.2** Monedha do të jetë: [specifikoni monedhën]

**2.3** Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Furnizuesit sipas formularit të mëposhtëm

**2.4** Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: ______________________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, sigurimi mbetet i pandryshuar.

**Neni 3 Inspektimi dhe Testet**

**3.1** Inspektimet dhe testet do të jenë:

**3.2** Inspektimi para dërgesës: [specifiko inspektimin dhe testet]

Pranimi përfundimtar: [specifiko inspektimin dhe testet]

Inspektimet dhe testet do të kryhen në: _____________________

**4.1** **Neni 4 Dorëzimi**

Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë:

Dërgesat dhe dokumentet e tjera që duhet të sigurohen nga Furnizuesi janë:

(a) Kushtet e dorëzimit, datat dhe vendet e dorëzimit të mallrave dhe pjesëve të këmbimit do të përmbushen në përputhje me Grafikun e Dorëzimeve të parashikuar në këtë Kontratë.

(b) Furnizuesi do të njoftojë Blerësin ______ ditë para çdo dorëzimi të mallrave.

(c) Njoftimi i dorëzimit do të bëhet me shkrim, me faks, postë elektronike, etj. tek: ___________________________________________________________________

(ç) Nëse Blerësi i merr mallrat nga një palë e tretë, njoftimi i dorëzimit përfshin listën e dokumenteve të nevojshme për marrjen e mallrave dhe përshkruan dokumentet që do t'i jepen Blerësit.

(d) Nëse Blerësi i merr mallrat nga një palë e tretë, Furnizuesi do të dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme për marrjen e mallrave tek: _____________________________________

**Neni 5 Çmimi i Kontratës**

Çmimi i Kontratës është: _________________________

**Neni 6 Kushtet e pagesës**

**6.1** (a) Pagesa e mallrave do të bëhet brenda _________ ditëve nga data e pranimit të Mallrave ose nga data e marrjes së kërkesës për pagesë me shkrim, pavarësisht nga dita e ardhjes. Nëse nuk specifikohet, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

(b) Pagesa do të bëhet në monedhën______. Nëse lihet e paplotësuar, pagesa do të bëhet në monedhën Shqiptare.

**6.2** Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

**Neni 7 Shërbimet në Lidhje me to**

Kushtet e veçanta të mëposhtme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

__________________________________________________________________________

**Neni 8 Paketimi dhe Dokumentet**

Paketimi, shënjimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë paketave duhet të jetë: **[*vendos detajet e kërkuara për shënjimin dhe dokumentacionin e paketimit]***

**Neni 9 Siguracioni**

Nëse nuk është në përputhje me Inkotermat, mbulimi i sigurimit do të jetë si më poshtë ***[specifikoni kërkesat e sigurimit]***

**Neni 10 Transporti**

Përgjegjësia për rregullimin e transportit të Mallrave do të jetë në përputhje me Inkotermat e specifikuara.

Nëse nuk është në përputhje me Inkotermat, përgjegjësia për transportin do të jetë si më poshtë: ***[specifikoni organizimet e transportit, nëse ndryshojnë nga sa më sipër]***

**Shtojca 19**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit/enti kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit /entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 20**

# Draft i Marrëveshjes Kuadër Ku përcaktohen të gjitha kushtet

**MALLRA**

[Përdorimi i kësaj drafte marrëveshje është i detyrueshëm për të gjithë autoritetet/entet kontraktore që do të përdorin Marrëveshjen Kuadër]

**Nr . __ datë :**

Kjo Marrëveshje është lidhur më [datë] ndërmjet [emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor], këtu e tutje referuar si "Autoriteti /Enti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktorit] përfaqësuar nga [përfaqësuesi], këtu e më tej referuar si "Kontraktori ".

Kontraktori, përmes ofertës së tij, me datë [data] pajtohet të furnizojë mallrat, siç specifikohet në kushtet e përcaktuara në:
-Këtë Formular;
-Formularin e Deklarimit të Ofertës të paraqitur nga Ofertuesi;
-Specifikimet Teknike;
-Listën e Çmimeve të Artikujve.

Të gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura, si pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i Marrëveshjes Kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e mallrave të mëposhtme.

[ Përshkrim i përgjithshëm ]

1.2 Marrëveshja Kuadër do të zbatohet duke dërguar ftesa për oferta tek Operatorët Ekonomikë, palë në marrëveshje sipas nevojave të Autoritetit/entit kontraktor.

1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin/Entin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime në çmimet për njësi, për shembull nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara të specifikuara dhe / ose nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të mos blejë cilëndo nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:_______________________________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për mallra përshkruhen në Listen e Çmimit të Artikujve.

2.2 Çmimet për njësi do të jenë fikse dhe nuk do të ndryshojnë për porositë e bëra në bazë të kësaj Marrëveshje Kuadër.

**Nënshkrimet dhe datat**

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin /Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## Shtojca 21

### Draft Marrëveshja Kuadër Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

### MALLRA

Emri i Autoritetit/Enti Kontraktor,

dhe

Emri i Kontraktorit

Bien dakord si më poshtë:

**Të nënshkruajnë Marrëveshjen Kuadër për objektin**: <shëno titullin> me numrin identifikues: <*shëno numrin e prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**.
1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat që do të lidhen përmes procesit të Mini – konkurrimit vetëm midis Operatorëve Ekonomik që janë palë në këtë Marrëveshje Kuadër.

1.2 Kjo Marrëveshje Kuadër nuk është një kontratë në vetvete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen, bazuar në të.

1.3 Kontraktori është vetëm një prej palëve të Marrëveshjes Kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti /Enti Kontraktor, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë Kontraktuesit një "Ftesë për Ofertë" sa herë që ka nevojë për mallra.

2.2 Kontraktori është i detyruar të paraqesë një Ofertë sa herë që kërkohet nga Autoriteti /enti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër**

1.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkurrimit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrimit**

4.1 Procesi i mini-konkurrimit do të zhvillohet me të gjithë operatorët ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër, kurdoherë që ka nevojë për mallra nga ana e Autoritetet/entet Kontraktore.

4.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të rihapë konkurrimin në të njëjtat kushte ose kushte të tjera të përcaktuara në Ftesën për Oferta, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit.

4.3 Sa herë që ka nevojë për mallra, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit Ftesat për Oferta dhe i dërgon ato te të gjithë Operatorët Ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër. Vlerësimi i Ofertave do të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Oferta.

**Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër** _________________________________

**Firmat dhe Data**__________________________________________________________

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin/Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## SEKSIONI IV

## Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

**Shtojca 22**: Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 23**:Formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 24**: Njoftimi i Kontratës së nënshkruar

**Shtojca 25**: Njoftimi i kontratës së nënshkruar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

**Shtojca 26:** Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit, në përfundim të afateve të ankimimit

**Shtojca 22**

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatoresh ekonomike)*

__________________________________________________

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

__________________________________________________

Nuis/Nipt

__________________________________________________

Adresa

| Qyteti | Shteti | Kodi Postar / Posta |
|---|---|---|

| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |
|---|---|

__________________________________________________

E-mail

__________________________________________________

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

*Plotësoni numrin e referencës se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

__________________________________________________

2. **Lloji i Procedurës**

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

☐

3. Autoriteti /Enti Kontraktor
*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

______________________________________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit
(*Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

______________________________________________________________________

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).*

______________________________________________________________________

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës
(*Data (viti/muaji/dita*)

______________________________________________________________________

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit

(*Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme*)

___

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(*Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës*)

___

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

1.Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

___

2. **Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumenteve të tenderit

☐

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

| Po | Jo |
|---|---|
| ☐ | ☐ |

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

7. **Lista e informacionit konfidencial**:

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

## Shtojca 23:

**FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

**Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar drejtuar**:

Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i Operatorit/ëve Ekonomikë/Bashkimit të operatorëve ekonomikë**

______________________________________________

Emri i plotë i Operatorit Ekonomik/Operatorëve Ekonomikë (ju lutem shtypeni)
Nuis/Nipt

______________________________________________

Adresa

______________ ______________ ______________

Qyteti Shteti Kodi Postar / Posta

______________________ ______________________

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

______________________________________________

E-mail

______________________________________________

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për dërgimin e këtyre kundërshtimeve (ju lutemi shkruani)

______________________ ______________________

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar Data (viti/muaji/dita)

______________________ ______________________

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

______________________________________________

*Plotësoni numrin e referencës se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

______________________________________________________________________

**2. Lloji i Procedurës**

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

______________________________________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

______________________________________________________________________

*Vlera e përllogaritur e kontratës/* Marrëveshjes Kuadër *(shuma në shifra dhe fjalë)*

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

______________________________________________________________________

*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader*.

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

______________________________________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

7. Ankesa që po shqyrtohet:

(*emri i Operatorit ekonomik që ka paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi*)

__________________________________________________

8. Data e Publikimit të Njoftimit të Fituesit

Data (viti/muaji/dita)

**Seksioni III. Argumentet mbi ankesën e paraqitur nga Operatori/ët ekonomikë**

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. Deklaratë e hollësishme e argumenteve mbi ankesën e paraqitur

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin argumentimet tuaja. Për çfarëdo arsye, specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e këtyre argumenteve. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Tenderit, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë nëse është e nevojshme.*

3. Lista e informacionit konfidencial

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të argumentimeve tuaja, si dhe të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

**Shënim: Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të LPP, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.**

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Operatorit /eve Ekonomikë**

**Shtojca 24**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar**

**<u>Seksioni 1 Autoriteti/Enti Kontraktor</u>**

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor**

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Tel/Faks ______________________________

E-mail ______________________________

Ueb-faqe ______________________________

**I.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| Institucion qendror | Institucion i pavarur |
|---|---|
| □ | □ |
| Njësia e Qeverisjes Vendore | Të tjera |
| □ | □ |

1.3 **Procedura e prokurimit për lidhjen e kësaj kontrate është zhvilluar nga:**

| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta | Organ Qendror blerës | Ofruesi sherbimit Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| □ | □ | □ | □ |

| I deleguar | Të tjera |
|---|---|
| □ | □ |

**Seksioni 2. Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës / Lotit**

________________________________________

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Furnizim"**

| Blerje | Qira | Blerje me këste | Një kombinim i tyre |
|---|---|---|---|
| □ | □ | □ | □ |

**2. Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po □ Jo □

**Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik** □

**Me disa operatorë ekonomik** □

**Të gjitha kushtet janë të vendosura** Po □ Jo □

**2.4 Përshkrimi i shkurtër i kontratës**

2. Fondi limit________________________________________
3. Burimi i financimit ________________________________________
4. Objekti i Kontratës ________________________________________

**2.5 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i përfundimit:**
Kohëzgjatja në **muaj** □□□ **ose ditë** □□□□

ose

Duke nisur □□/□□/□□□□ dhe përfunduar në □□/□□/□□□□

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po □ Jo □

*Nëse po,* numri i LOTEVE**:** □□

**2.7 Kontrata me nënkontraktim:**

Po □ Jo □

**Seksioni 3. Procedura**

**3.1 Lloji i procedurës: E kufizuar**

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A)oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □**

Sipas rëndësisë: Çmimi □□ **pikët □**

etj. □□ **pikë**

*ose*

**B)oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □**

**3.3 Numri i ofertave të paraqitura: □□□**

**Numri i ofertave të rregullta: □□□**

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), kur standardet nuk janë të zbatueshme, aprovimi paraprak merret nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.**

Po □ Jo □

**Seksioni 4 Informacion rreth Kontratës**

**4.1 Numri i kontratës: ___________________________________ Data e kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ___________________________________________________________________________

Adresa ___________________________________________________________________________

Nipti_______________________________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail__________________________________________________________________________

Ueb-faqe ___________________________________________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nënkontraktorit**

Emri __________________________________________________________________________

Adresa __________________________________________________________________________

Nipti ___________________________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail_______________________________________________________________________

Ueb-faqe_____________________________________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e Kontratës** *(përfshirë shumë, opsione dhe nënkontraktime):*

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha ________________________________

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ________________________________

**4.3.1 Vlera totale e nënkontraktimit:** ____

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha ________________________________

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ________________________________

**4.4 Informacion Shtesë**

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

Data e dorëzimit të këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 25**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri ___________________________________
Adresa ___________________________________
Tel/Faks ___________________________________
E-mail ___________________________________
Ueb-faqe ___________________________________

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: ___________________________________**

**3. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: ____________________________**

**4. Numri i referencës së procedurës /Lotit: ____________________________**

**5. Fondi limit**: _______ Monedha, _____ pa TVSH.

**6. Data e Publikimit në SPE** të Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit _______:

[10]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit *[Data] (Numri)*

**7. Vlera totale përfundimtare e kontratës (***përfshirë Lotet, opsionet dhe nënkontraktimin)*:

Vlera _______________ *(me TVSH)* Monedha ___________________________

**8. Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ___________________________________________________________________________
Adresa ___________________________________________________________________________
Numri i NIPT-it ______________________________________________________

***OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ☐

[10] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtij njoftimi në BNJP*

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Vlera e nënkontraktimit _______________ *me TVSH* Monedha _________________________

**8. Data e nënshkrimit të kontratës**

**_________________________________________________________________**

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

**Shtojca 26**

(*Shtojce për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*)

**FORMULARI I ANULIMIT TË PROCEDURËS, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ________________________________________________
Adresa ________________________________________________
Tel/Faks ________________________________________________
E-mail ________________________________________________
Ueb-faqe ____________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ___________**

**3. Numri i Referencës së procedures/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës ________________________________________________**

**5. Fondi Limit________________________________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

☐*në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
☐*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
☐*konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
☐*për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*
☐*kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;*
☐*kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.*

**7. Data e publikimit** në SPE të Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit:____

[11]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Anullimit nga i cili nisin afatet e ankimit [ Nr] [date]

**8.** Ankesa pas Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO☐

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

---

[11] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtij njoftimi në BNJP*

Në përfundim të afatit për paraqitjen e ankesave ______/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to, procedura e prokurimit me objekt “___________”, anullohet.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**